



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2/2020 regjistër (JR)
Datë 09.01.2020

Nr. 33 i vendimit
Datë 03.11.2021

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 03.11.2021, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Branko Hrvatin, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ndini Tavani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës, neni A e në vijim i Aneksit të Kushtetutës; Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 62 e vijues dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; Kodi i Procedurave Administrative; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim dhe parashtrimet me shkrim para seancës gjyqësore, i cili kërkoj ndryshimin e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoj relatoren e çështjes, gjyqtaren Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ndini Tavani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, me përparësi nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), duke qenë kandidat për prokuror në Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Ndini Tavani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), Komisioni, bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:

- deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i rishikuar në vijimësi, ku ka konstatuar *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ndini Tavani*.

2.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse si më sipër, Komisioni kreu procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale, duke marrë vendimin nr. 199, datë 11.10.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni, me vendimin nr. 199, datë 11.10.2019, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ndini Tavani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “c” dhe 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë.

4.1 Për kriterin e vlerësimit të pasurisë:

- *Për pasurinë e identifikuar nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të shumës 2.500.000 lekë, të pretenduar me burim krijimi të ardhura nga avokatia për vitet 2003-2004. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me diferencën e konstatuar në deklaratën “vetting” dhe atë para fillimit të detyrës për vitin 2006, për shumën e deklaruar në rubrikën “të ardhurat”, me burim të ardhura nga avokatia. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në shumën 673.390 lekë për të paguar këstin e dytë të kësaj pasurie në vitin 2016, blerjen e automjetit po në këtë vit, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare.*

- *Për pasurinë e identifikuar nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sikurse është parashikuar në germen “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

- *Për pasurinë e identifikuar nr. 7, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me pakësimin e gjendjes “cash” në vitin 2009 dhe rezulton në balancë negative në shumën 611.044 lekë për blerjen e kësaj pasurie.*

- *Për pasurinë e identifikuar nr. 9, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mos provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij për masën e kontributit, për të ribërë analizën e mëtejshme financiare.*

- *Për çështjen e identifikuar nr. 10, subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të plotë, në kuptim të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

Në tërësi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe të të ardhurave me burim nga ushtrimi i profesionit të avokatit, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germen “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

4.2 Për kriterin e kontrollit të figurës:

Për subjektin e rivlerësimit Ndini Tavani nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmohet se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

4.3 Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale:

Gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara për moskryerje të hetimeve të plota, mosadministrimin e procedimeve penale, mosrealizimin e procedimeve penale në mënyrë efektive dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për sa kohë që jo në pak çështje të adresuara nga një numër i lartë i denoncuesve, u konkludua se vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit ishin prishur nga organet e gjyqësorit, madje edhe në mënyrë të përsëritur, i vlerëson ato si veprime dhe mosveprime të kryera, jo për shkak të paaftësisë profesionale të subjektit, por që dëshmojnë

për sjellje të tij në mospërbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

5. Subjekti i rivlerësimit, më datë 30.12.2019, ka paraqitur ankimin e tij ndaj vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 199/1, datë 06.01.2020.
6. Në ankim dhe në parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore¹ (në vijim “parashtrimet”), subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”) shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, pasi ka vlerësuar të nevojshëm debatin gjyqësor, në kushtet kur Komisioni në tërësinë e procesit të rivlerësimit kalimtar ndaj tij, nuk ka zbatuar parimet e procesit të rregullt ligjor, ka bërë konstatimin e gabuar dhe në mënyrë jo të plotë të gjendjes faktike të pasurisë dhe aftësive profesionale, si dhe ka bërë interpretim ligjor të gabuar me qëllim rëndues ndaj tij.
7. Nga shqyrtimi tërësor i ankimit dhe i parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit, janë evidentuar në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit si më poshtë.

A. Shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe anën procedurale të procesit të rivlerësimit

7.1 Komisioni ka zbatuar një standard të dyfishtë për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të aftësive profesionale, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm për çështje të ngjashme.

7.2 Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, pasi ka dhënë, marrë, përpunuar, përdorur, publikuar informacion bankar dhe të dhëna personale për prindërit e subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar ata persona të tjerë të lidhur në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit.

7.3 Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante afatin ligjor për arsyetimin dhe zbardhjen e vendimit, duke i cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën e ankimit.

B. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

7.4 Vlerësimi i Komisionit për pasuritë apartament banimi në Tiranë dhe automjet tip “Citroen C 5” është i pavërtetë, i pabazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

7.5 Subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2009, si dhe për të mbuluar shpenzimet e këtij viti.

7.6 Pasuria apartament banimi me sipërfaqe 65 m², në lagjen “{***}”, Tiranë, nuk është pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe ky fakt është deklaruar saktësisht prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke korrigjuar deklarinimin e pasaktë në deklaratën e interesave private të vitit 2006, e për pasojë konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë pasuri është në kundërshtim me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ.

¹ Parashtrimet me shkrim, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit pesë ditë para seancës gjyqësore, janë regjistruar në Kolegji me nr. {***} prot., datë 28.10.2021.

7.7 Qëndrimi i Komisionit, se prindërit e subjektit të rivlerësimit janë persona të tjerë të lidhur me të, është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe me jurisprudencën e Kolegjit.

C. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

7.8 Për dosjen nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, por këto shpjegime nuk janë konsideruar nga Komisioni.

7.9 Vendimi i pushimit të procedimit penal në dosjen nr. 3, është marrë pas analizës së akteve që ndodheshin në dosje dhe vlerës së dhënë provave dhe akteve prej tij si prokuror i çështjes.

7.10 Vlerësimi i Komisionit për denoncimin e shtetasit A. R., për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, nuk është i bazuar.

7.11 Vlerësimi i Komisionit për faktet e denoncuara nga shtetasi E. S. nuk qëndron, pasi çështja e analizuar vijonte të ishte në hetim dhe gjykim, në kohën e dhënies së vendimit për procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, duke u analizuar në këtë mënyrë nga Komisioni, në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

7.12 Për denoncimin e shtetasit V. Ç. për procedimin penal nr. {***}/2018, Komisioni ka bërë një vlerësim alogjik e abstrakt, duke përdorur terma të përgjithshëm që nuk ndërlidhen në asnjë moment me çështjen.

7.13 Vlerësimi i Komisionit për denoncimin e shtetasit I. S. nuk qëndron, pasi sipas legjislacionit procedural penal, kontrolli i gjykatës mbi vendimet e prokurorit nuk sjell në asnjë rast konkluzionin se hetimet kanë qenë të mangëta në kuptim të përgjegjësisë lidhur me aftësitë profesionale të prokurorit.

7.14 Vlerësimi i Komisionit në lidhje me informacionin publik mediatik, por edhe nga një denoncim i publikut, për procedimin penal nr. {***}/2017 në ngarkim të shtetasit F. Ç., nuk është i bazuar.

7.15 Konkluzioni i Komisionit se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke aplikuar si bazë shkarkimi pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të qëndrojë as logjikisht dhe as ligjërish.

8. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar ndryshimin e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
9. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte bashkëlidhur ankimit, ndërsa bashkëlidhur parashtrimeve ka depozituar:
 - a) vërtetim nr. {***} prot., datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për çështjen penale nr. {***} regjistri themeltar, datë e ardhjes së dosjes pranë gjyqtares së kësaj gjykate, datë 24.12.2019;
 - b) vërtetim nr. {***} prot., datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, për çështjen penale nr. {***} regjistri themeltar, datë regjistrimi 20.04.2021;
 - c) vërtetim nr. {***} prot., datë 28.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për kërkesën penale nr. {***} akti, datë regjistrimi 03.06.2019.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. *Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit*

10. Ankimi i subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit të Komisionit nr. 199, datë 11.10.2019, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) në dhomë këshillimi, në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 49 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012, i ndryshuar”).
Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues, në vijim, vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve.
11. Në këndvështrim të të gjitha konkluzioneve të paraqitura në vendimin e Komisionit dhe të gjithë pretendimeve të parashtruara në ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi ndonjë shkelje procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike në kuptim të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, që do të sillte nevojën e debatit gjyqësor në Kolegj për korrigjimin e tyre, siç pretendon subjekti i rivlerësimit.
12. Subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur ankimit nuk paraqiti akte në cilësinë e provave të reja. Për sa u përket provave të reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet para seancës gjyqësore, trupi gjykues vlerëson se ato nuk plotësojnë kërkesat e parashikuara prej neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin vetëm parashtrime me shkrim, por jo prova të reja, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Fakti që këto prova janë paraqitur bashkëlidhur parashtrimeve para seancës gjyqësore, i përjashton ato nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre në zgjidhjen e çështjes. Pavarësisht plotësimin të këtij kriteri formal të mospranueshmërisë së tyre për shqyrtim, Kolegji çmon se megjithëse këto akte nuk do të arrinin të ndikojnë në zgjidhjen e çështjes edhe sikur të konsideroheshin me vlera të plota provuese në drejtim të fakteve që subjekti kërkon të provojë nëpërmjet tyre, në një qëndrim garantist, referimi te to shërben vetëm për të plotësuar panoramën e ecurisë së çështjeve të trajtuara në vlerësimin profesional, pas marrjes së vendimit të Komisionit për subjektin e rivlerësimit. Kolegji arriti në përfundimin se, në referencë të parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, debati gjyqësor nuk ishte i nevojshëm dhe se lidhur me këtë çështje mund të arrihej në vendim nga shqyrtimi mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
13. Në Kolegj janë regjistruar: me nr. {***} prot., datë 24.10.2019, denoncimi i z. S. M.; me nr. {***} prot., datë 24.12.2020, denoncimi i z. F. D., i përcjellë nga Institucioni i Komisionerëve Publikë; dhe me nr. {***} prot., datë 18.06.2021, denoncimi i shtetasve K. P., B. P., M. P. dhe N. P.
Pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi mosfillimin e hetimit kryesisht për to, pasi asnjëri prej tyre nuk përmbante informacione të mjaftueshme mbi rrethanat për faktet që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor

14. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante afatin ligjor për arsyetimin dhe zbardhjen e vendimit, duke i cenuar subjektin të rivlerësimit të drejtën e ankimit*, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se vendimi i Komisionit është shpallur në seancën e datës 11.10.2019, por i është njoftuar nga Komisioni më datë 18.12.2019, pa dhënë asnjë rast përjashtimor dhe ndonjë shkak të pamundësisë absolute që do të justifikonte këtë vonesë dymujore të zbardhjes së vendimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, e drejta e ankimit cenohet nga vonesat e pajustificuara të kryera nga Komisioni, në shkelje flagrante të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, e cila përcakton afatin brenda të cilit duhet bërë zbardhja e vendimit. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin gjyqësor, të përcjellë nga Komisioni në Kolegj, trupi gjykues konstaton se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 13.12.2019, me lëndë “Njoftim i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Ndini Tavani”, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit me vendimin e marrë për të. Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, gjendet dëftesa postare e cila mban datën 16.12.2019, si datë e dorëzimit të akteve nga Komisioni në shërbimin postar dhe datën 18.12.2019, si datë e dorëzimit të akteve nga shërbimi postar te subjekti i rivlerësimit. Dëftesa e marrjes së akteve është nënshkruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. B. T.
15. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se pika 7 e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 vendos detyrimin që subjektin të rivlerësimit, Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë t’u njoftohet vendimi me shkrim, në të cilin janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore në të cilën shpallet vendimi përfundimtar. Nga leximi në harmoni i neneve të sipërcituara të ligjit nr. 84/2016, rezulton se ushtrimi efektiv i së drejtës së ankimit prej subjektit të rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 61, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me njoftimin dhe njohjen e subjektit të rivlerësimit me vendimin me shkrim të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur më datë 18.12.2019, me vendimin e arsyetuar me shkrim të Komisionit, ka paraqitur ankimin e tij në kundërshtim të këtij vendimi, më datë 30.12.2019, ankim i cili është pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 199/1, datë 06.01.2020. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se edhe pse vendimi nr. 199, datë 11.10.2019, nuk është zbardhur brenda afatit ligjor, Komisioni ka përmbushur efektivisht detyrimin për njoftimin e subjektit të rivlerësimit me këtë vendim, në zbatim të kërkesave procedurale për njoftimin e tij dhe për pasojë subjekti i rivlerësimit nuk është cenuar në të drejtat e tij për ushtrimin e ankimit, duke mos pasur si rrjedhojë shkelje të parimit të procesit të rregullt ligjor.
16. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *Komisioni ka shkelur në mënyrë flagrante nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), pasi ka dhënë, marrë, përpunuar, përdorur, publikuar informacion bankar dhe të dhëna personale për prindërit e subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar ata persona të tjerë të lidhur në kundërshtim me parashikimet ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit*, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se shkelja e pretenduar ka ndodhur pasi prindërit e tij janë bërë objekt hetimi administrativ nga Komisioni pa miratimin e tyre, janë hetuar mundësitë e tyre të kursimit, si dhe janë publikuar të dhënat e tyre personale, duke nënkuptuar kështu cenimin e së drejtës së jetës private. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky cenim ka ardhur si pasojë e konsiderimit nga Komisioni

të prindërve të tij si persona të tjerë të lidhur, në kundërshtim me parashikimet e nenit 14, pika 3 e ligjit nr. 84/2916 dhe me jurisprudencën e Kolegjit.

17. Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision, por edhe gjatë seancës dëgjimore publike të zhvilluar më datë 07.10.2019², trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka pranuar kryerjen e hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, për sa i përket verifikimit të krijimit të të ardhurave dhe pasurive të prindërve të tij, si dhe ka pranuar se i janë vënë në dispozicion të gjitha aktet e prodhuara nga ky hetim administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Komisioni gjatë seancës dëgjimore publike, që prindërit e tij, sidomos babai i tij, të mos konsideroheshin si persona të tjerë të lidhur, por në asnjë moment gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, subjekti nuk ka pretenduar se prindërve të tij iu është shkelur e drejta e jetës private, në bazë të nenit 8 të KEDNj-së.

Nga verifikimi i vendimit të Komisionit, të publikuar në faqen zyrtare në internet të këtij të fundit, rezulton se të dhënat në lidhje me prindërit e subjektit të rivlerësimit janë pasqyruar të anonimizuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

18. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se prindërve të tij u është cenuar e drejta e jetës private lidhet me konsiderimin e tyre nga Komisioni si persona të tjerë të lidhur me të. Pavarësisht vlerësimit të bërë në këtë vendim se konsiderimi nga ana e Komisionit i prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur është i gabuar, trupi gjykues vëren se subjekti gjatë hetimit administrativ në Komision ka mbajtur një qëndrim aktiv, duke i vënë në dispozicion Komisionit dokumentacion të nevojshëm për të justifikuar krijimin e pasurive nga ana e prindërve të tij. Gjithashtu, trupi gjykues nuk mund të lërë pa vënë re faktin se subjekti i rivlerësimit ka ngritur në nivelin e një shkaku ankimi, jo cenimin e të drejtave të veta, por të personave të tretë dhe nuk ka argumentuar në lidhje me pasojat konkrete të ardhura nga shkelja e pretenduar.

Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, duke u shkëputur nga konstatimet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se neni A i Aneksit të Kushtetutës³ parashikon kufizime të të drejtave kushtetuese, sipas kushteve të parashikuara nga neni 17 i Kushtetutës, që lidhen me respektimin e jetës private, si dhe dispozitat që lidhen me barrën e provës, në funksion dhe përgjatë procesit të rivlerësimit. Neni 17 i Kushtetutës⁴ parashikon garancinë e kufizimeve të të drejtave dhe lirive vetëm me ligj, për një interes publik. Përputhshmëria me Kushtetutën dhe nenin 8 të KEDNj-së e kufizimeve me ligj të së drejtës së privatësisë në funksion dhe brenda nevojave të procesit të rivlerësimit, është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 2/2017 është shprehur se: “[...] Gjykata vëren se ndërhyrja në këtë rast justifikohet me interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret, ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 të KEDNj-së, si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë [...]”. Edhe GjEDNj-ja, në një situatë të ngjashme, në çështjen A. Xh. kundër Shqipërisë, është shprehur se: *Gjykata vëren se, gjatë*

² Sipas procesverbalit të seancës dëgjimore të datës 07.10.2019.

³ Neni A, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “1. Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 12 , 131, nënparagrafi “f”, 135, 13 , 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës”.

⁴ Neni 17 i Kushtetutës parashikon: “1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

vlerësimin të zbatueshmërisë së nenit 8 në rastin aktual, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet sipas një qasjeje të arsyeshme: largimi i kërkueses nga detyra e gjyqtarës nuk ka asnjë lidhje me jetën e saj private. Blerja ose krijimi i aseteve mund të konsiderohet si një aspekt i jetës private, por nuk është numri ose madhësia e aseteve ose stili i jetës së një individi si i tillë, që të mund të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, por është pamundësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për blerjen ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij ose të saj. Në çdo rast, gjykata konsideron se një auditim i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të jetës private që në vetvete të trajtohet si një shkelje etike. [...] Në këto rrethana, gjykata nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga Ligji i Vettingut në përgjithësi, dhe ndërhyrja në rastin e aplikantit në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, të renditura në nenin 8, paragrafi 2 i Konventës⁵. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se hetimi administrativ i kryer nga Komisioni ka respektuar kriteret kushtetuese e ligjore, pa tejkalluar në asnjë rast qëllimin e tyre.

19. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit Komisioni, ka zbatuar një standard të dyfishtë për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të aftësive profesionale, duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm për çështje të ngjashme, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit në argumentimin e tij për këtë shkak ankimi, ka cituar disa vendime të Komisionit, si vendimi nr. 161, datë 18.06.2019, vendimi nr. 17, datë 04.06.2018 dhe vendimi nr. 84, datë 27.11.2018, në të cilat ka qenë e njëjta relatore, anëtare e trupës gjykues, që ka kryer procesin e rivlerësimit edhe për subjektin e rivlerësimit. Subjekti pretendon se në procesin e zhvilluar ndaj tij, relatorja, me rekomandimet e dhëna trupës gjykuese, ka vepruar në kundërshtim me këtë praktikë, duke zbatuar standard të dyfishtë në gjykimin e çështjeve.

Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson si vijon.

Së pari, ky pretendim duhej paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, pasi qëndrimi i Komisionit në lidhje me çështje të caktuara të vlerësimit të secilit prej kriterëve, është shprehur paraprakisht që në rezultatet e hetimit administrativ, në të cilat subjekti i ka kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën e gjetjeve të hetimit administrativ dhe subjekti i rivlerësimit është njohur me qëndrimin e Komisionit që në këtë fazë të procesit të rivlerësimit. Subjekti, gjatë zhvillimit të procesit të rivlerësimit në Komision, nuk ka paraqitur asnjë pretendim në lidhje me ndryshimin e qëndrimit të Komisionit për çështje të caktuara krahasuar me praktikën e tij për çështje të ngjashme.

Së dyti, Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese⁶, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësimi, në përputhje edhe me nenin 10 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton: “Gjykata mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor”. Nuk është roli i Kolegjit, madje edhe në rastet që në pamje të parë duken të krahasueshme ose të ngjashme, në lidhje me rrethanat e faktet e paraqitura në to, të krahasojë vendimet e ndryshme të dhëna nga Komisioni, për subjekte të ndryshme.

⁵ Shih paragrafët 358-393 të vendimit të GjEDNj-së në çështjen A. Xh. k. Shqipërisë.

⁶ Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës: “5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese [...]”.

C. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë

20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar të gjitha konkluzionet që ka mbajtur Komisioni pas kontrollit të pasurisë dhe verifikimit të deklarimeve të tij, duke pretenduar se vendimi i Komisionit, për sa u përket konkluzioneve lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, është i padrejtë për shkaqet e mëposhtme.
21. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit vlerësimi i Komisionit për pasuritë apartament banimi në Tiranë dhe automjet tip “Citroen C 5” është i pavërtetë, i pabazuar në aktet e administruara gjatë hetimit administrativ dhe në kundërshtim të plotë me ligjin nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës⁷, nga hetimi administrativ i kryer në Komision, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.

21.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

1. Apartament banimi, ndodhur në rrugën “{***}”, {***}, pranë restorant {***}, pallati “{***}” ShPK, kati i {***}, ap. {***}, sipas kontratës premtim-shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2015, në vlerën 4.500.000 lekë, paguar deri ditën e paraqitjes së deklaratës, shuma 3.000.000 lekë. Burimi i të ardhurave për shumën e paguar: nga pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes dhe të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës si prokuror. Diferenca e shumës prej 1.500.000 lekësh do të paguhet ditën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes, sipas parashikimit në kontratë. Paguar vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

2. Automjet, tip “Citroen C5”, blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, në vlerën 900.000 lekë. Burimi i të ardhurave nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes në vite. Pjesa takuese: 100%.

21.2 Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratën premtim-shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2015, të lidhur mes tij e bashkëshortes në cilësinë e palës premtuese të blerjes dhe shoqërisë “{***}” ShPK në cilësinë e palës premtuese të shitjes, për shitblerjen e një apartamenti me sipërfaqe totale 109,84 m², për çmimin prej 4.500.000 lekësh. Sipas nenit 4 të kësaj kontrate, mënyra e pagesës për këtë pasuri është parashikuar, si vijon: shuma prej 1.500.000 lekësh do të likuidohej 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës; kësti i dytë prej 1.500.000 lekësh do të likuidohej brenda 90 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës; diferenca prej 1.500.000 lekësh do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës.

21.3 Në deklaratën periodike të interesave për vitin 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar ndër të tjera, pakësimet dhe shtesat në llogaritë bankare të djalit E. T. në shumën 500.000 lekë, të vajzës K. T. në shumën 450.000 lekë dhe të bashkëshortes B. T. në shumën 550.000 lekë, shuma të cilat kanë kaluar në llogarinë e tij bankare dhe më pas nga kjo llogari është paguar kësti i parë i apartamentit të banimit kundrejt shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK.

21.4 Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank⁸, rezulton se:

⁷ Nisur nga fakti se pagesa për këstin e dytë për blerjen e pasurisë apartament banimi në vitin 2016, dhe pagesa për blerjen e automjetit në të njëjtin vit kanë burim të njëjtë - kursimet e akumuluar ndër vite, për shkak se pretendimet e subjektit të rivlerësimit kanë qenë të njëjta për të dyja pasuritë, pasi arsyetimi dhe analiza financiare e Komisionit është e njëjtë për to, trupi gjykues vlerësoi t'i trajtojë pretendimet e subjektit të rivlerësimit duke i përmbledhur në një shkak ankimi.

⁸ Informacioni është përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2019.

Më datë 14.12.2015, është debituar llogaria nr. {***} në emër të znj. B. T. në vlerën 500.000 lekë dhe është kredituar llogaria nr. {***} në emër të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “Krijim gjendje kontratë kredi shitje apartamenti”.

Më datë 28.12.2015, është debituar llogaria nr. {***} në emër të E. T. në vlerën 500.000 lekë dhe është kredituar llogaria nr. {***} në emër të subjektit të rivlerësimit, me përshkrimin “Krijim gjendje kontratë kredi shitje apartamenti”.

Më datë 28.12.2015, është debituar llogaria nr. {***} në emër të vajzës së subjektit K. T. në shumën 450.000 lekë dhe është kredituar llogaria nr. {***} në emër të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “Krijim gjendje kontratë kredi shitje apartamenti”.

Në total, në llogarinë e subjektit të rivlerësimit ka kaluar vlera 1.500.000 lekë.

Nga verifikimi i veprimeve të mëtejshme bankare, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

Më datë 22.12.2015, me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, ka paguar shumën 500.000 lekë për llogari të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK.

Më datë 28.12.2015, me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”, ka paguar shumën 1.000.000 lekë për llogari të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK.

21.5 Në deklaratën periodike të interesave të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Pakësim i gjendjes cash të përdorur për këstin e dytë të banesës sipas kontratës premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2015, blerjen e makinës dhe udhëtim jashtë vendit në Itali dhe Mal të Zi me bashkëshorten dhe fëmijët dhe shpenzime të tjera. Vlera 2.040.000 lekë. [...]* *Blerje automjet Citroen, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, me kursime në vite dhe paga e bashkëshortes. Vlera 900.000 lekë. Pjesa takuese 100%.* *Paguar kësti i dytë sipas kontratës premtim shitje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.12.2015, nga kursimet në vite dhe paga e bashkëshortes. Vlera 1.500.000 lekë. Pjesa takuese 100%.*

21.6 Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank dhe nga Credins Bank⁹, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

Më datë 27.10.2016, ka likuiduar shumën 500.000 lekë, me depozitim *cash* në Raiffeisen Bank për llogari të firmës ndërtuese “{***}” ShPK.

Më datë 27.12.2016 ka paguar shumën 1.000.000 lekë me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Credins Bank” për llogari të firmës ndërtuese “{***}” ShPK.

21.7 Bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka paraqitur kontratë shitblerje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, me palë shitëse znj. L. T. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit, për shitblerjen e automjetit tip “Citroen C 5”, për çmimin prej 900.000 lekësh. Sipas nenit 3 të kësaj kontrate, palët kanë rënë dakord që çmimi do të paguhet jashtë zyrës noteriale, brenda një jave nga data e nënshkrimit të kontratës.

21.8 Nga informacioni i përcjellë në Komision nga Credins Bank, rezulton se subjekti i rivlerësimit:

Më datë 27.12.2016, ka derdhur *cash* në llogarinë e tij me nr. {***}, pranë Credins Bank, shumën 900.000 lekë.

Më datë 29.12.2016, ka kryer transaksionin bankar drejt shtetasës L. T., duke paguar shumën 900.000 lekë, për blerjen e automjetit.

22. Komisioni në vendim, bazuar në situatën faktike të rezultuar nga hetimi administrativ, ka arritur në konkluzionin se: [...] *i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm lidhur me*

⁹ *Informacion i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2019, dhe nga Credins Bank, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.05.2019.*

burimin e krijimit të shumës 2.500.000 lekë, të pretenduar me burim krijimi të ardhura nga avokatia për vitet 2003-2004.

ii. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me diferencën e konstatuar në deklaratën “vetting” dhe atë para fillimit të detyrës për vitin 2006, për shumën e deklaruar në rubrikën “Të ardhurat”, me burim të ardhura nga avokatia.

iii. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në shumën 673.390 lekë për të paguar këstin e dytë të kësaj pasurie në vitin 2016, blerjen e automjetit po në këtë vit, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare.

23. Në kundërshtim të konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se:

23.1 Të ardhurat nga profesioni i avokatit, të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në shumën 1.839.000 lekë për periudhën 2003-2004, përbëjnë dhe shumën e burimit të krijimit të pasurive të tij, e cila duhet analizuar për qëllim të procesit të rivlerësimit. Nuk mund të anashkalohet ky deklaram nga Komisioni, i cili i është referuar vetëm deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2006 në lidhje me të ardhurat nga avokatia, në kundërshtim me parashikimet e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të cilat imponojnë referimin në deklaratën e rivlerësimit.

23.2 Në referim të dokumentacionit të disponuar nga ana e subjektit të rivlerësimit për periudhën në të cilën ka ushtruar profesionin e avokatit, ai ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit si të ardhura të cilat u janë nënshtruar tatimeve, shumën totale prej 1.849.000 lekësh, të cilat konsiderohen të ardhura të ligjshme në referim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Të ardhurat neto të realizuara nga aktiviteti si avokat, sipas të dhënave të pagesave të detyrimeve tatimore dhe taksës vendore mbi biznesin e vogël, janë në total në vlerën 1.394.675 lekë dhe këto janë të ardhurat *neto* të cilat duhet të merren në konsideratë si fitim *neto* i realizuar nga ky aktivitet, në analizën e të ardhurave të subjektit të rivlerësimit.

23.3 Të ardhurat totale të realizuara nga subjekti i rivlerësimit, për të cilat disponohet dokumentacion i plotë justifikues ligjor për periudhën deri në tetor 2006, janë: të ardhura nga aktiviteti i avokatisë shuma 1.394.675 lekë; të ardhura nga avokat kryesisht shuma 274.000 lekë; të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës 897.315 lekë; në total të ardhurat neto në shumën 2.565.990 lekë. Të ardhurat neto në këtë shumë dhe të ardhurat nga puna si asistent avokat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 2.500.000 lekësh, deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën fillestare të vitit 2006.

23.4 Arsytimi dhe konkluzioni i Komisionit se të ardhurat e përfituara si asistent avokat nuk ekzistojnë dhe për këtë arsye nuk mund të merren në konsideratë, është në kundërshtim me ligjin, pasi Kushtetuta dhe ligji parashikojnë si të ardhura të ligjshme ato për të cilat janë paguar tatimet, por ky parashikim është i detyrueshëm kur të ardhurat janë përdorur për pasuritë e subjektit përgjatë periudhës së rivlerësimit. Të ardhurat e përfituara nga puna si asistent avokat gjatë vitit 2002 nuk mund të zhbëhen nga Komisioni, pasi detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e kishte avokati pranë të cilit subjekti punonte si asistent.

23.5 Shuma prej 2.500.000 lekësh, e disponuar *cash* para fillimit të detyrës në vitin 2006, gjatë viteve është pakësuar dhe shtuar, duke shërbyer si burim krijimi për pagesën e këstit të dytë të apartamentit dhe blerjes së automjetit në vitin 2016, duke rezultuar e provuar se subjekti i rivlerësimit i ka krijuar këto pasuri me burime të ligjshme.

24. Trupi gjykues shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në raport me konkluzionet e Komisionit, situatën faktike të rezultuar nga hetimi administrativ e legjislacionin e zbatueshëm dhe vlerësoi si vijon.
25. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 18.1 më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim, ka verifikuar burimet e krijimit të pagesës së kështit të dytë të apartamentit të banimit, i cili sipas deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit përbëhet nga *pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes dhe të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës si prokuror*.
Në kuadër të këtij verifikimi, Komisioni, në vendim, arsyetimin e tij e ka mbështetur në deklaramin e subjektit të rivlerësimit mbi kursimet *cash* në vlerën 2.500.000 lekë, të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, e cila sipas deklaramit të subjektit buronte nga të ardhurat nga avokatia në vitet 2003-2004, në shumën 2.500.000 lekë. Komisioni, në analizën e të ardhurave nga avokatia për vitet 2003-2004, nuk i është referuar në asnjë moment deklaramit të subjektit në deklaramin e pasurisë së rivlerësimit, dhe në përgjigje të të njëjtit pretendim të subjektit të ngritur edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, në vendim ka arsyetuar: “Trupi gjykues, nisur nga faktet se burimi i pasurisë së deklaruar në deklaratën “vetting”, “të ardhura nga avokatia”, derivonte dhe ndërthurej me vite të mëparshme kalendarike, në pikënisje që me deklaramin e tij në deklaratën periodike për vitin 2006, ka verifikuar deklaratën periodike, për faktin se kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaramet e mëparshme, i shërbeu Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij. Po në këtë drejtim, trupi gjykues ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, mund të jenë edhe deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja. [...] Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e burimit të ligjshëm të krijimit të gjendjes *cash*, nis dhe duhet të vlerësohet sipas deklaramit të bërë në deklaratën “vetting”, nuk qëndron edhe për shkak të kontradiktoritetit të subjektit në këto deklarime: i. Subjekti në deklaratën “vetting”, në rubrikën e të ardhurave, deklaronte të ardhura në shumën 897.315 lekë nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura në shumën 1.839.000 lekë nga avokatia. Pra, në total, deklaronte të ardhura në shumën 2.736.315 lekë. ii. Subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës, për vitin 2006, në rubrikën e të ardhurave, kishte deklaruar të ardhura në shumën 900.000 lekë nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura në shumën 2.500.000 lekë nga avokatia. Pra, në total, deklaronte të ardhura në shumën 3.400.000 lekë. iii. Subjekti pretendon se shuma e deklaruar e të ardhurave nga avokatia në vitin 2006 ka pasur të përfshirë edhe të ardhurat e ushtrimit të profesionit si asistent avokat”.
26. Në analizë të qëndrimit të mësipërm të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se duhet të sjellë në vëmendje jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, në lidhje me vlerën e provës së deklarimeve të mëparshme të interesave pranë ILDKPKI-së. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 u ka njohur vlerën e provës deklarimeve të mëparshme të interesave privatë, për të përcaktuar përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit në raport me deklaramin e tij në deklaratën e rivlerësimit, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016. Në rastin konkret, Komisioni, megjithëse ka arsyetuar mbi vlerën e provës së deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, analizën e tij në lidhje me burimet e krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit e ka mbështetur vetëm në këtë deklaratë. Komisioni nuk e ka nisur kontrollin nga deklaramet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit, dhe më tej të bënte ballafaqimin e krahasimin e këtij deklarimi me atë të para fillimit të detyrës në vitin 2006, por është përqendruar vetëm në kontrollin e deklarimeve të

subjektit në këtë të fundit. Në arsyetim, në verifikimin e deklaramit të para fillimit të detyrës, Komisioni është mbështetur në dokumentacionin justifikues të paraqitur nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së rivlerësimit, çka tregon se të njëjtën linjë arsyetimi do të kishte ndjekur edhe nëse kontrolli do të fillonte nga verifikimi i deklaramit të subjektit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por fillesa e kontrollit nga kjo deklaratë është e lidhur ngushtë me konkluzionet që do të duhet të arriheshin në përfundim të procesit të kontrollit të pasurisë përkatëse, në zbatim të parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Fillesa e kontrollit nga deklarata e pasurisë së rivlerësimit merr rëndësi në përcaktimin e përgjegjësisë së subjektit të rivlerësimit në kontekst dhe për qëllim të këtij procesi. Në konkluzionet e tij, Komisioni është i paqartë në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket konkluzionit të Komisionit në vendim, se subjekti ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm lidhur me diferencën e konstatuar në deklaratën e rivlerësimit dhe atë para fillimit të detyrës për vitin 2006, për shumën e deklaruar në rubrikën “Të ardhurat”, me burim të ardhura nga avokatia, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i diferencave mes deklarimeve në deklaratën e rivlerësimit dhe deklarimeve të mëparshme në ILDKPKI, nuk përbën detyrim ligjor për subjektet e rivlerësimit, e aq më tepër të përbëjë shkak për ngarkimin e subjektit të rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore.

27. Komisioni, duke analizuar vetëm deklaramin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2006, e madje duke arritur në konkluzione që ngarkojnë subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore vetëm për këtë deklaratë, i është larguar qëllimit dhe objektit të kontrollit të pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit, të cilët kanë përcaktuar qartësisht se procesi i rivlerësimit fillon nga deklarimet e subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të rivlerësimit për secilin prej kritereve, në rastin konkret në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni, në analizën e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit, duhet të kishte filluar procesin e rivlerësimit në verifikimin dhe kontrollin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e më tej të krahasonte e analizonte atë në raport me deklarimet periodike të interesave në kuptim të provës në këtë proces. Konkluzionet e arritura nga Komisioni duhet t’i referoheshin përgjegjësisë disiplinore të subjektit të rivlerësimit lidhur me deklarimet e tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit e për më tepër të ishin të qarta në lidhje me shkeljet konkrete sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

28. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 18.2 më sipër, trupi gjykues konstatoi si vijon.

Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: *Të ardhura nga avokatia 2003-2004. Vlera 1.839.000 lekë.*

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit:

- Formularin “Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, datë 02.06.2003, për subjektin Ndini Tavani, Avokat, Berat, dokument i cili mban vulën e Degës së Tatim Taksave Berat dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit dhe inspektorëve tatimorë përkatës. Sipas këtij formulari, të dhënat e deklaruara nga subjekti janë: qarkullimi i deklaruar: 375.000 lekë, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, kësti I: 3.750 lekë; taksa vendore mbi biznesin e vogël: 20.000 lekë; tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, kësti II: 7.500 lekë.

- Formularin “Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, datë 03.03.2004, për subjektin Ndini Tavani, Avokat, Berat, dokument i cili mban vulën e Degës së Tatim Taksave Berat dhe nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit dhe inspektorëve tatimorë përkatës. Sipas këtij formulari, të dhënat e deklaruara nga subjekti janë:

qarkullimi i deklaruar: 1.200.000 lekë, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, kësti I: 18.750 lekë; taksa vendore mbi biznesin e vogël: 30.000 lekë; tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, kësti II: 30.000 lekë¹⁰.

29. Në vendim, Komisioni, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga ushtrimi i aktivitetit të avokatit nga subjekti i rivlerësimit, ka arsyetuar se: [...] në analizën e kryer nga Komisioni për fitimin e realizuar nga ky profesion, është marrë në konsideratë vetëm qarkullimi i deklaruar në formular, përkatësisht shuma 375.000 lekë për vitin 2003 dhe shuma 1.200.000 lekë për vitin 2004. Komisioni, nisur nga eksperiencia me subjekte të tjera, i ndodhur para faktit të mungesës së fitimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, ka aplikuar një marzh fitimi 80%, pasi nga qarkullimi duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit, si qira, shërbimet utilitare dhe shpenzime të tjera të nevojshme. [...] Nën arsyetimin sa më sipër, nga përlllogaritjet, duke aplikuar marzhin e fitimit prej 80%, fitimi neto për vitet 2003 dhe 2004 rezultoi në shumën 1.260.000 lekë. Të ardhurat nga gjykata dhe prokuroria Berat rezultuan në shumën 274.000 lekë dhe në total të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit për vitet 2003-2004 rezultuan në shumën 1.534.000 lekë¹¹.

Subjekti i rivlerësimit, në ankim, fillimisht ka pretenduar se të ardhurat e tij nga avokatia në periudhën 2003-2004 janë ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit në shumën totale prej 1.849.000 lekësh, të cilat konsiderohen të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar tatimet, në referim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Më tej, në ankim, në kontrast me sa më sipër, ka pretenduar se të ardhurat neto të realizuara nga aktiviteti i avokatisë, pasi janë zbritur detyrimet tatimore, janë në vlerën 1.394.675 lekë dhe në kushtet kur nuk është evidentuar asnjë shpenzim tjetër i kryer në kuadër të ushtrimit të aktivitetit si avokat, në analizën e të ardhurave duhet të merret në konsideratë kjo vlerë, si fitim neto i realizuar nga ky aktivitet¹².

30. Trupi gjykues vëren se nga formularët “Tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin” për vitet 2003 dhe 2004, të përshkruar në paragrafin 18 më sipër në këtë vendim, rezulton se qarkullimi total për vitet 2003-2004, përlllogaritet në shumën 1.575.000 lekë, ndërsa detyrime tatimore për vitin 2003 në shumën 31.250 lekë dhe në vitin 2004 në shumën 82.500 lekë.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes së Komisionit drejtuar me e-mail-in e datës 24.06.2019, ka paraqitur mandatpagesat e taksave dhe tatimeve për periudhën 2003-2004, në të cilat përfshihen edhe mandatpagesa të detyrimeve të tjera, si pagesa për taksë pastrimi, taksë tabele etj.

Nga hetimi administrativ i realizuar nga Komisioni, vërehet se ky i fundit ka administruar edhe shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat nr. {***} prot., datë 08.07.2019, në të cilën gjenden bashkëlidhur të dhënat nga sistemi informatik tatimor mbi pagesat analitike të kryera nga subjekti i rivlerësimit për periudhën 2003-2004.

¹⁰ Subjekti, bashkëlidhur deklaratës ka paraqitur edhe:

- Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. {***}, datë 13.05.2003, “Mbi regjistrimin e personit fizik” të z. Ndini Tavani, për ushtrimin e aktivitetit “Avokat” dhe Autorizimin Administrativ nr. {***}, për vitin 2003, datë 26.05.2003, për subjektin avokat, z. Ndini Tavani, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

- Vërtetimin nr. {***} prot., datë 12.10.2016, të ISSh, Drejtoria Rajonale Berat, sipas të cilit, z. Ndini Tavani, si subjekt privat i vetëpunësuar në qytet, ka paguar sigurimet shoqërore për periudhën 13.05.2003-30.06.2004. Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet formulari nr. {***} prot., datë 12.10.2016, i ISSh, Drejtoria Rajonale Berat, i cili pasqyron kontributet sipas pagave mujore të derdhura nga z. Ndini Tavani për periudhën e sipërcituar.

- Vendimin nr. {***}, datë 12.11.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat “Mbi çregjistrimin e personit fizik” të z. Ndini Tavani, për ushtrimin e aktivitetit “Avokat”.

¹¹ Faqet 7-8 të vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

¹² Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni.

Sa më sipër, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka qenë në dijeni të të dhënave në lidhje me detyrimet e paguara nga subjekti i rivlerësimit, duke mos u gjendur kështu në kushtet e aplikimit të marzhit të fitimit 80%, pasi rasti konkret nuk është i njëjtë me “eksperiencat me subjekte të tjera”, siç është shprehur Komisioni në vendim¹³. Qëndrimi i Komisionit, në konsiderimin e të dhënave të rezultuara nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit është kontradiktor, pasi Komisioni ka pranuar vlerën totale të qarkullimit të deklaruar bazuar në këto të dhëna, por nuk ka pranuar shumat e paguara si detyrime tatimore që rezultojnë referuar në të njëjtat të dhëna.

31. Nga verifikimi i kujdesshëm i dokumentacionit të administruar nga Komisioni, bazuar në vlerën e detyrimeve tatimore të paguara nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 2003-2004 [taksa, tatime, pagesa për sigurimet shoqërore etj.], rezulton se të ardhurat *neto* të tij nga ushtrimi i profesionit të avokatit për këtë periudhë, duhet të kenë qenë në shumën 1.395.462 lekë. Kësaj shume duhet t'i shtohen edhe të ardhurat e përfituara si avokat i caktuar kryesisht, sipas të dhënave të pasqyruara në vërtetimin nr. {***} prot., datë 18.10.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe vërtetimin nr. {***} prot., datë 20.10.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, në total në shumën 274.000 lekë. Për pasojë, të ardhurat *neto* të përfituara nga subjekti i rivlerësimit nga ushtrimi i profesionit të avokatit, rezultojnë në shumën 1.669.462 lekë dhe jo në shumën 1.534.000 lekë sa ka përlllogaritur Komisioni në vendim, dhe jo 1.668.675 lekë sa ka përlllogaritur subjekti i rivlerësimit në ankim.

Nga arsyetimi si më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit ka deklaruar të ardhurat *bruto*, të realizuara nga ushtrimi i profesionit të avokatit, por duke qenë se të ardhurat *neto* janë ato që konsiderohen si burim i ligjshëm, bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës¹⁴, vlera prej 1.669.462 lekësh përbën të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Kolegj për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të krijonte pasuritë e tij, si burim të të cilave ka deklaruar “*të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës si prokuror*” në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim.

32. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 13.3 më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit, në faqen 3, ka deklaruar: *Gjendje cash në banesë të padepozituara. Vlera 2.500.000 lekë. Këto të ardhura i kam nga puna si avokat për periudhën 2003-2004. Pjesa takuese 100%*. Në vijim, në po këtë deklaratë, në rubrikën “Të ardhurat dhe angazhime në veprimtari private dhe/ose publike”, në faqen 4, ka deklaruar: *Të ardhurat gjatë dy viteve si student nga Shkolla e Magjistraturës. Vlera 900.000 lekë. Të ardhurat si avokat. Vlera 2.500.000 lekë.*

¹³ Në vendimin nr. {***}, datë 21.03.2019, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit P. Gj., vërehet se situata faktike e rezultuar nga dokumentacioni i mbledhur si pasojë e hetimit administrativ, është e ndryshme nga ajo e rezultuar nga hetimi administrativ në rastin konkret. Në vendimin nr. {***}, datë 21.03.2019, Komisioni ka referuar se: “Trupi gjykues vlerësoi se vlera e deklaruar e qarkullimit, për të cilat janë paguar edhe detyrimet tatimore për periudhën 2000-2010, është në total në masën 13.800.000 lekë, mbështetur në dokumentacionin e administruar nga organet kompetente. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion ligjor për të provuar se kishte përfutur të ardhurat e pretenduara”. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë Komisionit dokumentacionin vërtetues të pagesave të detyrimeve tatimore, të cilat i zbriten qarkullimit të deklaruar për të konkluduar mbi të ardhurat *neto* të subjektit të rivlerësimit nga ushtrimi i profesionit të avokatit, në periudhën 2003-2004.

¹⁴ Neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës parashikon: “3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në ankim, ka argumentuar se deklarimi i gjendjes *cash* prej 2.500.000 lekësh deklaruar para fillimit të detyrës në vitin 2006, i përgjigjet gjendjes reale dhe faktike të likuiditeteve *cash* të cilat ai i dispononte në atë moment.

Sipas subjektit të rivlerësimit, të ardhurat totale të realizuara prej tij, për të cilat disponohet dokumentacion i plotë justifikues ligjor, për periudhën deri në tetor 2006, janë:

- (i) të ardhura nga aktiviteti i avokatisë: shuma 1.394.675 lekë;
- (ii) të ardhura nga avokat kryesisht: shuma 274.000 lekë;
- (iii) të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës: 897.315 lekë.

Në total, të ardhurat *neto* janë në shumën 2.565.990 lekë.

Të ardhurat *neto* në këtë shumë dhe të ardhurat nga puna si asistent avokat kanë shërbyer për krijimin e shumës prej 2.500.000 lekësh, deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën fillestare të vitit 2006. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, duke qenë deklarimi për herë të parë, duhen marrë në konsideratë edhe pasaktësi të mundshme në plotësimin e saj. Sipas tij, në faqen 3 të kësaj deklarate, ka deklaruar gjendjen *cash*, e cila duhet lexuar dhe interpretuar lidhur ngushtë me deklarinimin në faqen 4 të po kësaj deklarate. Referenca në faqen 4, e ardhura nga avokatia në shumën 2.500.000 lekë, u përket të ardhurave nga avokatia dhe si asistent avokat. Në këtë kuptim, pretendon subjekti, duket qartë pasaktësia në deklarinimin e shumës *cash* të vlerës 2.500.000 lekë vetëm nga avokatia, pasi e njëjta vlerë është e vendosur nga ai dhe si e ardhur në të njëjtën deklaratë.

33. Në analizë të argumenteve të mësipërme të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren gjatë hetimit administrativ në Komision¹⁵, në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka mbrojtur deklarinimin e bërë në deklaratën para fillimit të detyrës se shuma prej 2.500.000 lekësh ka qenë shumë e kursyer nga të ardhurat e realizuara nga avokatia, pavarësisht se shuma e të ardhurave të pretenduara nga ushtrimi i profesionit të avokatit nuk përputhet me ato të deklaruara në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit [vlera 1.839.000 lekë]. Në vijim të hetimit administrativ të Komisionit, pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se shuma prej 2.500.000 lekësh përbëhej nga të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i avokatit, të cilat në vlerë *bruto* kanë qenë në shumën 1.575.000 lekë, nga të ardhurat si asistent avokat në vitet 2002-2003 dhe nga të ardhurat si student në Shkollën e Magjistraturës, qëndrim të cilin e ka mbajtur edhe në ankim. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk mund të kursente si gjendje *cash* shumën 2.500.000 lekë me të ardhurat e realizuara nga profesioni i avokatit, pasi këto të ardhura nuk kanë qenë në këtë vlerë. Në kushtet kur Komisioni, në arsyetimin e tij, në përfundim të analizës ligjore e financiare, ka konkluduar se shuma e cila mund të kursehej nga subjekti i rivlerësimit para fillimit të detyrës, me të ardhura nga profesioni i avokatit, përbën edhe shumën e kursimeve reale *cash* që ka pasur ai në banesë, në momentin e plotësimit të deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2006¹⁶, në zbatim të parimit “*no reformatio in peius*”, që garanton të drejtën e mbrojtjes së një subjekti në procesin e gjyqimit në një shkallë më të lartë

¹⁵ Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit drejtuar me e-mail-in e datës 24.06.2019, ka deklaruar: “Për vitin 2003, për xhiron nga 0 deri në 2 milionë lekë, kam paguar kuotën fikse, në shumën 20.000 lekë dhe për xhiron 375.000 lekë (xhiro nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit), kam paguar shumën 15.000 lekë, tatimi mbi xhiron, në masën 4%. Për vitin 2004, për xhiron nga 0 deri në 2 milionë, kam paguar kuotën fikse, në shumën 30.000 lekë dhe për xhiron 1.200.000 lekë (xhiro nga 2 deri në 8 milionë lekë në vit), kam paguar shumën 48.000 lekë, tatimi mbi xhiron, në masën 4%. Në këtë kuptim, referuar mandatpagesave, kam paguar taksat dhe tatimet për shumën 5.575.000 lekë, nga të cilat kam kursyer në gjendje *cash*, shumën 2.500.000 lekë, të disponuar dhe të deklaruar në kohën kur kam përpiluar deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006”.

¹⁶ Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 3, faqe 8 të vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

gjykimi, trupi gjykues arrin në përfundimin se në të njëjtën logjikë do të duhet të vazhdojë edhe analiza financiare në Kolegj, por në këtë analizë do të mbahet në konsideratë vlera prej 1.669.462 lekësh si kursim nga të ardhurat nga avokatia, e rezultuar nga diferenca mes qarkullimit të deklaruar dhe pagesës së detyrimeve tatimore për periudhën 2003-2004, sipas arsytimit të bërë në paragrafin 21 më sipër në këtë vendim.

34. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafit 13.4 më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim¹⁷, ka arsyetuar se: *Trupi gjykues, në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga ushtrimi i profesionit si asistent avokat nuk konteston faktin e përfaqësimit të subjektit në procese të ndryshme gjyqësore, penale dhe civile, apo faktin që ai ka punuar pranë një avokati të licencuar, ka përpiluar kërkesëpadi, ankime, rekurse etj., por bazuar në kërkesat e ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, se ligjshmëria e çdo të ardhure të përfituar bazohet në derdhjen e detyrimeve tatimore, konkludon se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor shumën e përfituar nga ushtrimi i këtij profesioni dhe për pasojë nuk provoi burimin e ligjshëm të tyre.*
35. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me këtë konkluzion të Komisionit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në ankim, por edhe në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ të Komisionit, ka pretenduar se të ardhurat e përfituara nga puna si asistent avokat pranë avokatit Sh. S. në qytetin e Beratit, kanë shërbyer si një nga burimet e krijimit për gjendjen *cash* prej 2.500.000 lekësh të deklaruar në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2006, por këto të ardhura nuk i ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit dhe as në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006.
- Gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për vitin 2002, ku rezulton se ai ka përfaqësuar në gjykim persona të ndryshëm, në cilësinë e asistent avokatit.
- Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.04.2019, të avokatit Sh. S., i cili ka deklaruar para noterit publik se z. Ndini Tavani, pas regjistrimit në regjistrin e asistentëve për avokat në Dhomën Kombëtare të Avokatisë, ka kryer stazhin si asistent avokat në zyrën e tij prej tremujorit të tretë të vitit 2001 deri në dhjetor të vitit 2002. Për shërbimet e ofruara, z. Tavani është paguar në shuma të ndryshme në formën e shpërblimit, nga avokati Sh. S., si dhe nga vetë klientët.
- Edhe në vërtetimin nr. {***} prot., datë 03.02.2016, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë rezultojnë të njëjtat të dhëna në lidhje me kryerjen e stazhit të subjektit të rivlerësimit si asistent avokat.
36. Nga sa më sipër, rezulton e provuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer stazhin si asistent avokat, fakt ky i pranuar edhe nga Komisioni në vendim, por nuk provohen të ardhurat e përfituara nga shërbimet e kryera prej tij gjatë kësaj periudhe. Edhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në asnjë moment, as gjatë hetimit në Komision dhe as në ankim, se sa ka qenë shuma konkrete e tyre. Në këto kushte, për këto të ardhura të pretenduara nuk provohet me dokumentacion financiar shuma e përfituar dhe as pagesa e detyrimeve tatimore mbi to, për rrjedhojë bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, ato nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme.
- Pretendimi i subjekti i rivlerësimit se ligjshmëria e të ardhurave është e detyrueshme kur të ardhurat janë përdorur për krijimin e pasurive përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk qëndron, pasi neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës vendos detyrimin për subjektin e rivlerësimit për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij, për më tepër vetë

¹⁷ Paragrafi 1.47 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

subjekti ka pretenduar se të ardhurat nga puna si asistent avokat i kanë shërbyer për krijimin e kursimeve me të cilat ka financuar blerjen e pasurive të tij.

37. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, ka kërkuar që në kushtet kur rezulton e provuar se përgjatë vitit 2002 ka punuar si asistent avokat, Komisioni duhet të kishte një qasje më elastike për këtë situatë në analizën financiare të tij për mundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 2.500.000 lekë në tetor të vitit 2006, ku minimalisht duhet të vlerësohej se të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si asistent avokat kanë mbuluar plotësisht të gjitha shpenzimet jetike për periudhën përkatëse (2002 – 2006 para fillimit të detyrës). Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se Komisioni, megjithëse në vendim¹⁸ ka arsyetuar se *pretendimi i subjektit që Komisioni të jetë më i elastik në njohjen e këtyre të ardhurave dhe t'i neutralizojë ato me shpenzimet e jetesës, për sa kohë ato nuk ekzistojnë, nuk mbështetet në asnjë bazë ligjore dhe për pasojë nuk mund të merren në konsideratë*, në analizën e bërë mbi mundësinë e blerjes së pasurive nga subjekti i rivlerësimit¹⁹, ka konsideruar si gjendje *cash* në banesë të ardhurat *neto* nga ushtrimi i profesionit të avokatit, duke barazuar të ardhurat me kursimet, për pasojë ka reflektuar një qëndrim tejet garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, qëndrim ky i vijuar edhe nga Kolegji në vlerën e konsideruar të kursimeve *cash* në banesë me burim të ardhurat nga avokatia²⁰.
38. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, në të njëjtën logjikë të analizës financiare të ndjekur nga Komisioni në vendim, me të cilën subjekti i rivlerësimit është njohur dhe ka paraqitur edhe pretendimet e tij në ankim, në zbatim të parimit “*no reformatio in peius*”, duke konsideruar shumën 1.669.462 lekë, si kursim *cash* para fillimit të detyrës, mbi të cilën janë shtuar e pakësuar kursimet *cash* në vite, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në shumën 536.818 lekë, për të paguar këstin e dytë të pasurisë apartament dhe blerjen e automjetit tip “Citroen C 5” në vitin 2016, në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
39. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni, ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, në vitin 2009, si dhe për të mbuluar shpenzimet e këtij viti, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2009 dhe për pasojë rezulton në balancë negative në shumën 611.044 lekë për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.
40. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se në analizën financiare të vitit 2009, Komisioni nuk duhet të kishte përlloritur krijimin e depozitës prej 5.200 eurosh, pasi ajo është krijuar në janar të vitit 2009 dhe ka pasur si burim të ardhurat familjare nga kursimet e vitit 2008. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim, një analizë financiare e cila reflekton atë të kryer nga Komisioni në vendim, por në zërin “Ndryshim likuiditeti” është zbritur vlera prej 717.600 lekësh, e cila është vlere e konvertuar e depozitës prej 5.200 eurosh. Sipas kësaj analize të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, situata e tij financiare rezulton me balancë pozitive prej 106.556 lekësh, që dëshmon se ai ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, si dhe për të mbuluar shpenzimet e vitit 2009.

¹⁸ *Ibid.*

¹⁹ *Sipas tabelës 3, në faqen 8 të vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.*

²⁰ *Shih arsyetimin në paragrafin 21 më sipër në këtë vendim.*

41. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton, si vijon.

41.1 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “Automjet Benz, prodhim i vitit 2000, blerë në vitin 2009, me targa {***}, në vlerën 7.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes. Shitur sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, në shumën 100.000 lekë”.

41.2 Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2009, në rubrikën “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme”, subjekti ka deklaruar: “Blerje automjeti, datë 27.07.2009, tip Benz, viti 2000, blerë në vitin 2009, e paregjistruar në DRShTRr Berat në emrin tim. Vlera 7.000 euro. Pjesa takuese 100%.

Depozitë pranë Raiffeissen Bank Berat me të ardhura nga kursimet e vitit 2008. Vlera 5.200 euro. Pjesa takuese 50%.

Depozitë *extra* pranë Raiffeissen Bank Berat. Vlera 202.000 lekë. Pjesa takuese 50%.”

Ndërsa në rubrikën “Detyrimet financiare pranë personave fizikë dhe juridikë”, ka deklaruar: “Kredi pranë Raiffeissen Bank, datë 08.10.2009, për blerje pajisje shtëpiake dhe shpenzime të tjera”. Shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm 53.400 lekë. Gjendja e detyrimit të mbetur pa shlyer 546.400 lekë”.

41.3 Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga DPSHTRr²¹ dhe sipas dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Komision, rezulton se ai, në cilësinë e blerësit, ka lidhur “Kontratë shitje makine” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.07.2009, me shoqërinë “{***}” ShPK, për blerjen e automjetit “Mercedes Benz C220 CDI”, vit i prodhimit 2000, në vlerën 7.000 euro. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar përpara noterit publik se e ka dorëzuar tërësisht shumën e mësipërme. Kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit më datë 08.06.2010.

41.4 Në përgjigje të pyetjes së Komisionit²², në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Burimi i ligjshëm i blerjes së këtij automjeti janë të ardhurat nga pagat e vitit 2009, kursimet në vite dhe përdorimi i kredisë së akorduar në këtë vit për kompensimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2009”.

41.5 Në përgjigje të pyetjes së Komisionit²³ në lidhje me faturat e blerjes së pajisjeve shtëpiake, sipas deklaratës periodike të interesave për vitin 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kredia në shumën 600.000 lekë është akorduar nga banka dhe sipas deklaratës periodike të vitit 2009 është deklaruar për blerje pajisjesh shtëpiake dhe shpenzime të tjera. Në periudhën e kërkesës dhe të akordimit të kredisë, kam jetuar në banesën e shtetasit Q. L. në Berat, së bashku me bashkëshorten dhe vajzën time. Shtëpia ka qenë në kushte minimale për të jetuar. Në këto kushte, kam blerë disa sende elektro-shtëpiake të përdorura [...], si dhe disa pajisje të tjera bazike për jetesë [...]. Shpenzimet totale për këto pajisje nuk e kanë kaluar shumën prej 100.000 lekësh”.

41.6 Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank²⁴, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka marrë kredi pranë kësaj banke, e cila është disbursuar më datë

²¹ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga DPSHTRr, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2019.

²² Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit, të përcjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision, më datë 19.04.2019.

²³ Në përgjigjet e pyetësorit nr. 5 të Komisionit, të përcjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision, më datë 04.07.2019.

²⁴ Informacion i përcjellë në Komision nga Raiffeisen Bank me shkresën nr. {***} prot., datë 07.05.2019.

08.10.2009 në shumën 600.000 lekë dhe është tërhequr nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit më datë 09.10.2009 në shumën 500.000 lekë dhe më datë 10.10.2009 në shumën 100.000 lekë.

41.7 Në përgjigje të barrës së provës së kaluar nga Komisioni, në lidhje me mungesën e burimeve financiare në shumën 611.044 lekë për blerjen e kësaj pasurie, si dhe përballimin e shpenzimeve të tjera familjare, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *vërej se në rubrikën “Ndryshim likuiditeti” është pasqyruar me të drejtë në kuptim të analizës vjetore të vitit 2009, depozita në shumën 5.200 euro krijuar në janar të vitit 2009, por sqarohet se kjo depozitë faktikisht është krijuar me të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2008. Meqenëse më parë nuk jam pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt, shpjegoj se krijimi i depozitës prej 5.200 eurosh në janar të vitit 2009, ka pasur si burim të ardhurat familjare nga kursimet e vitit 2008. Ky fakt është pasqyruar edhe në deklaratën periodike të vitit 2009, konkretisht në faqen 3 dhe 10 të saj, në deklarinim tim si subjekt dhe atë të personit të lidhur. Vetë data e krijimit të kësaj depozite krijon bindjen për origjinën e kësaj depozite. Për këto arsye, kërkoj që në analizën financiare të vitit 2009 të zbritet si zë ndryshimi (shtesa) e likuiditeteve në vlerën prej 5.200 eurosh. [...] Si përfundim, duket qartë që unë kam pasur mundësi financiare për të blerë automjetin në vitin 2009 dhe për të mbuluar shpenzimet gjatë këtij viti. Të njëjtin qëndrim, subjekti i rivlerësimit e ka mbajtur edhe në seancën dëgjimore në Komision²⁵ dhe në ankim.*

42. Trupi gjykues, në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me të gjitha rrethanat që kanë rezultuar të provuara gjatë hetimit administrativ të kryer, si dhe duke konsideruar edhe shpjegimet e deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në Komision, të cilat janë një prej mjeteve të kërkimit të provës për efekt të këtij procesi²⁶, vlerëson se çështja që shtrohet për zgjidhje është përcaktimi i burimeve financiare të përdorura nga subjekti i rivlerësimit për krijimin e pasurive gjatë vitit 2009, kryesisht blerjen e automjetit “Mercedes Benz” në vlerën 7.000 euro dhe krijimin e depozitë-s bankare në vlerën 5.200 euro dhe më pas verifikimi i mjaftueshmërisë së tyre.

43. Në analizë të deklaratimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave private të vitit 2009, në këndvështrim të dispozitave të ligjit nr. 9049/2003 dhe situatës faktike konkrete, vërehet se sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj.

Në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i krijimit të depozitës prej 5.200 eurosh në Raiffeisen Bank në janar të këtij viti, janë të ardhurat nga kursimet e vitit 2008, ndërsa në deklaratën periodike të vitit 2008, por edhe në atë të vitit 2007 nuk ka deklaruar shtesa ose pakësime të parave *cash* të akumuluar në vite.

Ndodhur në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit në vitin 2009 duhet lexuar e kuptuar si korrigjim i atij të vitit 2008, për sa kohë objekt i verifikimit janë deklaratimet periodike të interesave të deklaruara më parë në ILDKPKI, të cilat në bazë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mund të shërbejnë si provë në këtë proces, e për sa kohë që pavarësisht pasaktësisë në deklarinim e vitit 2008, nga analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2008, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur një tepriçë pozitive në këtë vit, në vlerën 652.686 lekë, vlerë që mbulon krijimin e shumës së depozituar në llogari bankare në janar të vitit 2009.

²⁵ *Procesverbal i seancës dëgjimore në Komision, datë 07.10.2019.*

²⁶ *Neni 49 i ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “1. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, Komisioni ose Kolegji i Apelimit ka të drejtë: [...] b) të mbledhë deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku [...]”.*

44. Në lidhje me pasurinë “automjet Mercedes Benz”, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj në deklaratën e interesave të vitit 2009, por në deklarimet në Komision gjatë hetimit administrativ është shprehur se kjo pasuri është krijuar si rezultat i përdorimit të të ardhurave nga pagat e vitit 2009, kursimet në vite dhe përdorimi i kredisë së akorduar në këtë vit për kompensimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2009. Pra, për krijimin e kësaj pasurie në vlerën 7.000 euro, e konvertuar në vlerën 907.550 lekë²⁷, bazuar në deklarimin e mësipërm, rezulton se subjekti ka përdorur kursimet në vite, të cilat më pas i ka kompensuar me shumën prej 500.000 lekësh nga kredia e marrë në Raiffeisen Bank më datë 08.10.2009, në shumën 600.000 lekë. Në lidhje me përdorimin e kredisë, Komisioni në vendim, pavarësisht se e ka reflektuar si të ardhur në analizën financiare të vitit 2009, në arsyetim është shprehur se: “Subjekti në pyetësorë ka ndryshuar burimin e krijimit për blerjen e automjetit, duke deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* dhe kompensimin e kësaj të fundit me kredinë e përfutur në këtë vit, që gjithashtu e kishte marrë me qëllim mobilimi, ndërsa në pyetësorë e deklaroi se me të kompensoi *cash*-in e prekur”. Nga verifikimi i deklarimit periodik të interesave në vitin 2009, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kredia është përdorur *për blerje pajisjesh shtëpiake dhe shpenzime të tjera*. Në këto kushte dhe bazuar në parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë koherent në deklarimin periodik të vitit 2009 dhe shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision, se gjendja e *cash*-it nuk ka ndryshuar për shkak të kompensimit të vlerës së prekur për blerjen e automjetit, me shumën prej 500.000 lekësh të mbetur nga kredia pas kryerjes së shpenzimeve të mobilimit, në vlerën 100.000 lekë.
45. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj, duke përdorur dy konkluzionet e mësipërme, rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte një tepricë pozitive prej 113.381 lekësh për vitin 2009, në ndryshim nga sa ka konkluduar Komisioni për një mungesë të burimeve të ligjshme për shumën prej 611.044 lekësh. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit gjendet i bazuar.
46. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *pasuria apartament banimi me sipërfaqe 65 m² në lagjen “{***}”, Tiranë, nuk është pasuri në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe ky fakt është deklaruar saktësisht prej tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, duke korrigjuar deklarimin e pasaktë në deklaratën e interesave private të vitit 2006, e për pasojë konkluzioni i Komisionit në lidhje me këtë pasuri është në kundërshtim me aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues vëren se Komisioni, pas kontrollit dhe vlerësimit të kësaj pasurie, është shprehur në vendim: *Trupi gjykues [...] i referuar deklarimit të subjektit për kontributin e dhënë, sado të ketë qenë ai, sikurse subjekti ka deklaruar ekzaktësisht në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006; ii. pa anashkaluar deklarimin përgjatë hetimit administrativ se kontributi i tij në këtë pronë është vetëm në vlerë monetare si e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006; iii. pa shkëputur vëmendjen nga konstatimi se subjekti me deklarimet e tij nuk është tërhequr nga ky kontribut; iv. gjatë hetimit ka deklaruar se e ka përdorur këtë pasuri për dy vjet 2011-2013, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara, mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mos provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij për masën e kontributit, për të ribërë analizën e mëtejshme financiare*²⁸. Sipas analizës financiare të bërë në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk kishte pasur mundësi të paguante shumën 2.190.516 lekë për 1/3 pjesë takuese për këtë pasuri e të*

²⁷ Sipas përlllogaritjeve të këshilltarit ekonomik të Kolegjit, vlera e automjetit 7.000 euro, e konvertuar me kursin e datës 27.07.2009, datë e lidhjes së kontratës së shitblerjes së automjetit, nga subjekti i rivlerësimit.

²⁸ Paragrafi 9.9.1 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

përballonte shpenzimet e tjera familjare, si edhe duke përlogaritur 1/3 pjesë takuese të kësteve të paguara për këtë pasuri, subjekti rezultonte në pamundësi financiare në shumën 2.038.248 lekë²⁹.

47. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin në vendimin e Komisionit, duke parashtruar se pasuria “apartament banimi me sipërfaqe 65 m² në lagjen “{***}”, Tiranë” është pasuri e porositur nga nëna e tij, sipas kontratës përkatëse të sipërmarrjes së vitit 2005 dhe e paguar prej saj sipas mandatpagesave përkatëse. Kjo pasuri posedohet qetësisht prej dy prindërve të tij dhe ai nuk ka asnjë të drejtë ligjore, nuk gëzon asnjë të drejtë reale dhe nuk ka asnjë pretendim mbi këtë pasuri, pasi në të kundërt të asaj që ka interpretuar Komisioni, nuk ka investuar dhe nuk ka financuar në këtë pasuri. Deklarimi i tij në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2006, ku ka shënuar thyesën 1/3 pjesë takuese në këtë pasuri, është bërë gabimisht për shkak të paqartësive në plotësimin e formularëve në atë kohë, por edhe nga bisedimet familjare të prindërve, të cilët e konsideronin atë banesë të të treve, duke qenë subjekti i rivlerësimit djalë i vetëm. Të dhënat e hedhura në paqartësi të formularëve në atë kohë, janë bërë nisur nga informacioni i dhënë nga nëna e tij deri në atë moment, prandaj dhe çmimi i apartamentit është deklaruar në vlerën 35.000 euro dhe jo 32.600 euro sa ka qenë vlera e kontratës së sipërmarrjes. Nisur nga traditat familjare dhe dashuria për prindërit, me dëshirën për të dhënë një ndihmesë pas fillimit të punës si asistent avokat dhe shpërbllimit për gjithë mundin dhe shpenzimet e shkollimit të tij, subjekti ka kontribuar modestisht për shpenzime jetike, sikundër ka ndihmuar edhe babain e tij në ushtrimin e aktivitetit të tij tregtar, duke iu gjendur pranë prindërve me çdo lloj ndihme të mundshme. Por kjo, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk e bën atë investitor dhe bashkëpronar në banesën e prindërve. Për këtë arsye, ai nuk ka deklaruar në asnjë deklaram periodik dhe as në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë, të drejta në lidhje me këtë pasuri. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përmbushja e detyrimit ligjor për deklarimin e pasurive të tij në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, pavarësisht se nuk përputhet me deklaramin e pasaktë të vitit 2006, nuk mund të përbëjë shkak penalizues për vijimin e karrierës së tij, apo për ta bërë atë bashkëpronar në një pasuri që nuk i përket.
48. Në vlerësim të këtij shkakut ankimi, nga shqyrtimi i akteve të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ³⁰, trupi gjykues konstaton situatën faktike si vijon.

48.1 Në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, të dorëzuar në ILDKPKI më datë 02.11.2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Apartament banimi me sip. 65 m², me adresë: lagjja “{***}”, i cili është në ndërtim, i pahipotekuar. (Apartamenti është ndërtuar me të ardhurat e prindërve të mi dhe të miat dhe nga puna). Vlera: 35.000 euro. Pjesa takuese: 1/3”.

48.2 Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti nuk ka bërë deklaram në lidhje me pasurinë e sipërcituar.

48.3 Në përgjigjet e pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni në lidhje me deklarimin si më sipër, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e dhëna më datë 19.04.2019, ka deklaruar: “Prona është në përdorim dhe posedim të prindërve të mi. Për këtë pasuri nuk ka asnjë barrë dhe nuk është tjetërsuar asnjëherë duke qenë në këtë status që në kohën e lidhjes së kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.01.2005. Ndërtimi vazhdon të jetë i pahipotekuar dhe nuk është kryer asnjë regjistrim në ZRPP. Kjo pasuri posedohet dhe përdoret nga prindërit e mi, të cilët para vitit 2004 kanë filluar të kontribuojnë për blerjen e kësaj prone për ta përdorur për të jetuar. Kontributi im në këtë prone

²⁹ Paragrafët 9.5 - 9.6 të vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

³⁰ Akte të administruara nga hetimi kryesisht i Komisionit dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorëve të drejtuar nga Komisioni dhe shpjegimeve mbi rezultatet e hetimit administrativ.

është vetëm në vlerë monetare, si e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, si kontribut për prindërit e mi dhe pa shprehur në asnjë rast pretendime mbi pasurinë, duke mos e konsideruar si pasuri të personit tim dhe në deklaratën *vetting*, pasi kjo pronë gëzohet qetësisht nga prindërit e mi. Nuk e konsideroj pjesë të pasurisë së familjes sime (unë, bashkëshortja ime dhe fëmijët e mi) dhe kontributi në para ka qenë detyrim ndaj prindërve të mi në aspektin njerëzor dhe prindëror”.

48.4 Në përgjigjet e dhëna Komisionit më datë 23.05.2019, ka deklaruar: “Pagesa është bërë në katër këste në momente të ndryshme, nga janari 2005 e deri në janar 2006, sipas përcaktimeve kontraktuale. Nga prindërit e mi, jam vënë në dijeni se për sa kohë nuk është realizuar nga subjekti ndërtues regjistrimi i pasurisë objekt kontrate, për të garantuar dhe siguruar plotësisht, në çdo moment marrëdhënien juridike civile nga dhe ndërmjet palëve sipas kontratës, ka mbetur pa paguar vlera 3.600 euro. Unë nuk kam asnjë të drejtë ligjore mbi këtë pasuri, nuk gëzoj asnjë të drejtë reale dhe rrjedhimisht nuk kam asnjë pretendim mbi këtë pasuri. Apartamenti me kontratë porosie është lidhur nga mamaja ime dhe sot gëzohet e posedohet qetësisht, bashkërisht, nga të dy prindërit e mi”.

48.5 Sipas vërtetimit të datës 12.10.2016 të Bashkisë Berat, subjekti i rivlerësimit ka bërë ndarje familjare nga prindërit me vendim të Këshillimit Bashkiak Berat nr. {***}, datë 27.05.1998.

48.6 Sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.01.2005, të lidhur mes znj. L. T. [nëna e subjektit të rivlerësimit] dhe shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK me seli në Tiranë, kjo e fundit ka marrë përsipër ndërtimin e një apartamenti (1+1, një banjë dhe dy ballkone) në favor të palës porositëse, për çmimin 32.600 euro.

48.7 Sipas mandateve të pagesave të kryera nga znj. L. T.³¹ ndaj shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, rezulton se në periudhën 13.01.2005 - 03.01.2006, ajo i ka paguar shoqërisë vlerën 29.000 euro.

48.8 Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga “Ujësjellës Kanalizime Tiranë” ShA, znj. L. T. është abonent me kontratë nr. {***} të vitit 2006, ndërsa sipas informacionit të përcjellë nga “Korporata Elektroenergjitike Shqiptare” ShA, librezja e furnizimit me energji elektrike është lëshuar në emër të znj. L. T.

48.9 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat shpjegime, duke theksuar se e ka ndihmuar familjen e tij me sa ka pasur mundësi, “në mënyrë periodike, në varësi dhe të rrethanave të kohës, gjithnjë në kuptim të solidaritetit moral ndaj prindërve, [...] në para të vogla të dhëna në varësi të situatës së momentit, kohës, muajit, që mund të jenë përdorur apo kursyer nga prindërit, duke ia bashkuar atë kursimeve të tjera të tyre”.

49. Në kuadër të vlerësimit të shkaqeve të ankimit të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit dhe konkluzionit të arritur nga Komisioni, trupi gjykues vëren se i gjithë arsyetimi i Komisionit për pasurinë apartament me sipërfaqe 65 m² në lagjen “{***}”, Tiranë (në vijim “apartamenti me

³¹ Mandatpagesë nr. {***}, datë 13.01.2005, paguar nga L. T., shuma 10.000 euro me përshkrimin “Për pagesën e kështit të parë për apartamentin 1+1”, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; mandatpagesë nr. {***}, datë 28.06.2005, paguar nga L. T., shuma 10.000 euro me përshkrimin “Për pagesën e kështit të dytë të shtëpisë në Tiranë”, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; mandatpagesë nr. {***}, datë 28. 10.2005, paguar nga L. T., shuma 7.000 euro me përshkrimin “Për kështin e tretë të shtëpisë në Tiranë”, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK; mandatpagesë nr. {***}, datë 03.01.2006, paguar nga L. T., shuma 2.000 euro me përshkrimin “Për një kësht për shtëpinë në rrugën “{***}” Tiranë”, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK. Mandatpagesat janë nënshkruar nga financieri dhe mbajnë vulën e shoqërisë “{***}” ShPK.

sipërfaqe 65 m²”), është orientuar rreth deklaramit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës më datë 02.11.2006, se kjo pasuri është krijuar me të ardhurat e prindërve të tij dhe të ardhurat e tij nga puna dhe sidomos në deklaramin e tij të pjesës takuese në 1/3 në këtë pasuri. Por, në konkluzionin e arritur nga Komisioni se: “subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramit të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara, mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mos provuar vërtetësinë e deklaramive të tij për masën e kontributit, [për të ribërë analizën e mëtejshme financiare]”, mbetet e paqartë se cila është pasoja ligjore që i atribuohet subjektit të rivlerësimit në kuadër të legjislacionit të zbatueshëm për rivlerësimin kalimtar, nëse paplotësia e deklaramit konstatohet në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit apo deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2006.

50. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson me rëndësi analizimin e deklaramive të subjektit të rivlerësimit në lidhje me marrëdhënien e tij me pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, në deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës në vitin 2006 dhe më pas në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit.
51. Në analizë të situatës faktike të pasurisë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, siç është pasqyruar në paragrafin 39 më sipër në këtë vendim, rezulton se:
- (i) kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.01.2005, për ndërtimin e apartamentit është lidhur me shoqërinë ndërtuese nga znj. L. T., nëna e subjektit të rivlerësimit, dhe pagesat e kryera për këtë pasuri deri në janar të vitit 2006 janë kryer nga ajo, në cilësinë e porositëses;
 - (ii) pasuria nuk është regjistruar ende në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për pasojë titulli i pronësisë nuk ka kaluar te znj. L. T.;
 - (iii) kontratat e furnizimit me ujë dhe energji elektrike për këtë pasuri janë lidhur në emër të znj. L. T., duke provuar marrëdhënien e saj me këtë pasuri, që buronte nga kontrata e porosisë e lidhur në vitin 2005;
 - (iv) subjekti i rivlerësimit, në regjistrat e gjendjes civile, rezulton i shkëputur nga familja e origjinës që nga viti 1998;
 - (v) në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si adresë banimi: “Lagjja “{***}”, pallati {***}, Berat;
 - (vi) pasaktësia në deklaramin e kësaj pasurie është pranuar dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, me argumentin se nuk ka deklaruar një të drejtë reale, por në paqartësi të asaj që kërkonte formulari i deklaramit dhe në kushtet e përfshirjes shpirtërisht në marrëdhënien prind-fëmijë, ka vendosur thyesën 1/3 në deklaramin e parë të pasurisë, në lidhje me pjesën takuese të tij në këtë pasuri.
52. Bazuar në këtë situatë faktike, të pranuar si të tillë edhe nga Komisioni në vendim³², në raport me legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vëren se, sipas nenit 9, “Deklarimi para fillimit të punës”³³, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), të gjitha subjektet që mbartin detyrimin për deklaramit, duhej të deklarorin para fillimit të punës të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinës së tyre. Ndërsa sipas nenit 4 të po këtij ligji, subjekti duhej të deklaronte pranë organit kompetent, ndër të tjera, pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to. Kjo kërkesë ka qenë e pasqyruar edhe në formularin “Deklaratë e interesave privatë para fillimit të detyrës”, miratuar nga Inspektori

³² Paragrafi 9.9 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019.

³³ Nen i shtuar me ligjin nr. 9530, datë 11.5.2006, “Për një shtesë në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar.

i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, e plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe e dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 02.11.2006. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës se zotëron 1/3 pjesë takuese në pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, nuk përputhet me dokumentacionin e paraqitur nga ai gjatë hetimit administrativ në Komision. Pakujdesia e subjektit të rivlerësimit në deklarimin e kësaj pasurie, duke deklaruar 1/3 pjesë takuese, megjithëse e paprovuar nga dokumentacioni ligjor lidhur me këtë pasuri, është reflektuar edhe në deklarimin e një vlere më të madhe blerjeje, nga ajo e përcaktuar në kontratë.

53. Në kuadër të analizës nëse një deklarim i pasaktë në deklaratën para fillimit të detyrës mund të prodhojë pasojat e një deklarimi të pasaktë edhe në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, vërehet se neni D i Aneksit të Kushtetutës, neni 3, pika 11 dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016 dhe shtojca nr. 2 e tij, vendos për subjektin e rivlerësimit detyrimin për të deklaruar të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, të cilat janë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

Referuar parashikimeve të Kodit Civil mbi të drejtat reale, nga hetimi administrativ në Komision, nuk u provua që në favor të subjektit të rivlerësimit të jetë vendosur hipotekë, servitut, e drejtë përdorimi/banimi, uzufukt apo enfiteoze mbi pasurinë në fjalë. Në këtë kuadër, subjekti i rivlerësimit, për sa kohë ka vërtetuar se nuk ka asnjë nga të drejtat e sipërcituara mbi pasurinë e paluajtshme në fjalë, nuk ka pasur detyrim për deklarimin e saj në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë së rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit se ka banuar personalisht, përkohësisht, në periudha të ndryshme kohore³⁴, në këtë apartament, së bashku me prindërit e tij, në kushtet e marrëdhënieve familjare, nuk mund të konsiderohet si e drejtë përdorimi/banimi e subjektit të rivlerësimit mbi këtë pasuri. Ky është një qëndrim i mbajtur tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës: “Konsiderimi i pasurive të paluajtshme të prindërve të subjekteve të rivlerësimit si pasuri në përdorim të këtyre të fundit, thjesht vetëm për faktin se subjektet shkojnë të vizitojnë prindërit e tyre, qoftë edhe duke qëndruar disa ditë atje, është në tejkalim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit në procesin e rivlerësimit, i parashikuar nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 84/2016”³⁵.

Për më tepër, nga hetimi administrativ nuk rezultoi asnjë e dhënë për rrethana të cilat mund të çonin në lindjen e një dyshimi të arsyeshëm në lidhje me ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shoqërinë ndërtuese “{***}” ShPK, pasi kjo pasuri është porositur dhe është paguar nga nëna e subjektit të rivlerësimit para emërimit të tij në detyrën e prokurorit. Referuar arsytimit të Komisionit në vendim, nuk rezulton që Komisioni të ketë bërë një vlerësim të kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, në drejtim të përpjekjes së subjektit të rivlerësimit për të fshehur këtë pasuri.

54. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim, në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, trupi gjykues vëren se në deklarimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, në asnjë fazë të hetimit, në konsekuencë, subjekti i rivlerësimit nuk ka pranuar që vlera e kontributit të tij në krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 65 m²” të ketë qenë sa 1/3 e vlerës së blerjes së tij, përkundrazi ai ka deklaruar se ka kontribuar modestisht për shpenzime

³⁴ Në përgjigjet e pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, të përcjella më datë 06.09.2019, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Nga viti 2006 (kohë e fillimit të detyrës) deri rreth fillimit të vitit 2008, kam banuar në banesën e prindërve të mi në Berat, lagjja {***}, pall. {***} dhe në banesën e prindërve të mi në Tiranë rruga “{***}”, pall. {***}. [...] Për periudhën 2011 deri rreth muajit shtator të vitit 2013, unë personalisht (për shkak të punës në Prokurorinë e rrethit Tiranë) kam jetuar disa ditë në javë në banesën e prindërve të mi në rrugën {***}, pallati {***}, Tiranë”.

³⁵ Vendimi i Kolegjit nr. 8/2020 (JR), datë 25.06.2020.

jetike, nga dëshira për të dhënë një ndihmesë pas fillimit të punës si asistent avokat, nisur nga dashuria për prindërit dhe shpërblimit të gjithë mundit dhe shpenzimeve gjatë viteve të shkollimit të tij. Në këtë kuptim, është i drejtë pretendimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimi i pjesës takuese në 1/3 për pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, nuk do të thotë *a priori* se edhe kontributi i tij në krijimin e saj ka qenë në të njëjtën masë në vlerë monetare. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit se ai nuk ka kontribuar në krijimin e kësaj pasurie në mënyrë të drejtpërdrejtë, aq më tepër në masën e 1/3 së vlerës së blerjes, janë bindëse për trupin gjykues, bazuar në konstatimet mbi situatën faktike të rrjedhur nga hetimi administrativ i Komisionit [siç është pasqyruar në paragrafin 39 më sipër në këtë vendim], për sa kohë dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nuk provon të kundërtën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

55. Rrethanat faktike që burojnë nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, qëndrojnë në harmoni me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, pavarësisht deklarimit në kushtet e paqartësisë në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës, ai nuk ka asnjë të drejtë reale mbi pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²” dhe nuk ka asnjë pretendim mbi të. Megjithatë nëneni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji, në rastin konkret, deklarimi i subjektit në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës nuk mbështetet nga dokumentacioni përkatës, në kushtet kur ky dokumentacion buron nga burime të njohura të provës, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për pasojë Komisioni nuk duhet t’i kishte dhënë vlerë të pakundërshtueshme këtij deklarimi, duke i vendosur detyrimin për provueshmërinë e burimit të ligjshëm të kësaj pasurie.
56. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se Komisioni nuk ka vlerësuar në mënyrë objektive faktet e provuara gjatë hetimit administrativ, pasi nga tërësia e tyre nuk ka rezultuar asnjë e dhënë, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit të ketë kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, me qëllim përfitimin e të drejtave reale mbi të, që të justifikojë verifikimin e burimit të ligjshëm të këtij kontributi. Për rrjedhojë, gjendet i pabazuar konkluzioni i Komisionit, për sa kohë nuk u arrit të provohet se subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 65 m²” dhe se ai posedon 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie.
57. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit *qëndrimi i Komisionit se prindërit e subjektit të rivlerësimit janë persona të tjerë të lidhur me të, është në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 84/2016 dhe me jurisprudencën e Kolegjit*, Komisioni në përfundim të procesit të rivlerësimit ka arsyetuar në vendim³⁶ se, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar të përfshijë në rrethin e personave të tjerë të lidhur prindërit, sipas parashikimit ligjor të bërë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, ka kryer në vijim analizën financiare lidhur me mundësinë e tyre për të krijuar të ardhura të pasqyruara në transaksione bankare, pasi në disa vite kalendarike kanë depozituar në llogaritë e tyre personale hera-herës shuma të konsiderueshme. Sipas analizës financiare të kryer në Komision për periudhën 1994-2016, mundësia e prindërve të subjektit për të kursyer deri në vitin 2005 ka qenë në shumën 1.250.825 lekë, ndërsa gjendja në bankë e tyre rezulton në shumën 3.794.045 lekë. Pra, rezulton një balancë negative në shumën 2.543.220 lekë. Ndërsa deri në vitin 2016 mundësia e prindërve të subjektit për të kursyer ka qenë në shumën 10.640.723 lekë, ndërsa gjendja në bankë është 13.816.873 lekë. Pra, rezulton një balancë negative në shumën 3.176.151 lekë. Komisioni, në lidhje me këtë çështje, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të paplotë, në kuptim të pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

³⁶ Paragrafi 10.14 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

58. Në kundërshtim të këtij arsytimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim se:
- (i) shkaqet e përmendura nga Komisioni për të përfshirë prindërit e tij si persona të tjerë të lidhur, jo vetëm nuk qëndrojnë, por edhe nuk bëjnë pjesë në shkaqet dhe përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i njëanshëm i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e interesave para fillimit të detyrës në vitin 2006, në lidhje me pjesën takuese në 1/3 në pasurinë e prindërve të tij, nuk mund të përbëjë fillimin për hetimin e të gjithë situatës financiare për prindërit e tij, duke e rikthyer procesin e rivlerësimit në një proces për prindërit e tij;
 - (ii) edhe nëse do të pranohej se prindërit e subjektit të rivlerësimit janë persona të tjerë të lidhur me të, atëherë analiza financiare do të duhej të kryhej vetëm për vitet 2005 dhe 2016, vite në të cilat sipas Komisionit prindërit e subjektit kanë qenë persona të tjerë të lidhur me të;
 - (iii) sipas dokumentacionit bankar të vënë në dispozicion nga vetë Komisioni, llogaria bankare e nënës së subjektit të rivlerësimit, për periudhën 2005-2013, është kredituar për paga, shpërblime, dieta, në vlerën totale 6.230.580 lekë, ndërsa nga Komisioni është përlllogaritur në vlerën 4.668.592 lekë. Ky korigjim nuk është kryer nga Komisioni në analizën financiare në vendim, megjithëse subjekti e ka parashtruar këtë kërkesë në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ;
 - (iv) Komisioni nuk ka përlllogaritur saktësisht të ardhurat e ligjshme të babait të subjektit të rivlerësimit nga aktiviteti i tij tregtar, në interpretim të gabuar të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ nga Drejtoria Tatimore Rajonale Berat dhe legjislacionit në fuqi për tatimet.
59. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues vëren se arsytimi i Komisionit në vendim është orientuar rreth verifikimit të mundësisë së prindërve të subjektit të rivlerësimit për të krijuar kursimet e tyre në formën e gjendjeve në llogaritë përkatëse bankare, për shkak të konsiderimit të tyre si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, duke iu referuar në mënyrë të shprehur parashikimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016³⁷. Për cilësimin e prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, Komisioni është mbështetur në këto fakte³⁸:
- 59.1 Subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në 1/3 pjesë takuese në pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²”, porositur nga nëna e tij në vitin 2005.
- 59.2 Marrëdhënia kontraktore e shitblerjes së një automjeti, e krijuar midis subjektit me nënën e tij në vitin 2016, pasi ngriti dyshime nisur nga raporti familjar.
- 59.3 Deklarimi i subjektit në pyetësorë se nga viti 2006 (kohë e fillimit të detyrës) deri rreth fillimit të vitit 2008 dhe për periudhën 2011 deri në muajin shtator të vitit 2013, për shkak të punës në Prokurorinë e Rrethit Tiranë ka banuar në banesën e prindërve të ndodhur në rr. “{***}”, pallati “{***}”, Tiranë.
60. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se vlerësimi i rrethanave të faktit në rastin konkret, duhet të fokusohet fillimisht në verifikimin nëse prindërit e subjektit gjenden ose jo në kushtet e kualifikimit si persona të tjerë të lidhur me të e më pas të detyrimit të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë së tyre. Në kuptim të këtyre dispozitave dhe të qëndrimeve tashmë të mbajtura në

³⁷ Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 parashikon se: “14. “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

³⁸ Paragrafi 10.1 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

jurisprudencën e Kolegjit³⁹, subjekti i kontrollit në procesin e rivlerësimit është subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, prandaj specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30-32 të ligjit nr. 84/2016, është që detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave e ka vetë subjekti i rivlerësimit, përfshirë këtu edhe detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuara nga persona të tjerë të lidhur, si dhe të pasurisë së dhënë hua apo të dhuruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në zbatimin e këtyre dispozitave në rastin konkret, në raport me rrethanat e trajtuara nga Komisioni në vendim, si rrethana që bëjnë të mundur kualifikimin e prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, rezulton se deklarimin e subjektit për kontributin në 1/3 pjesë takuese në pasurinë “apartament me sipërfaqe 65 m²” në deklarimin para fillimit të detyrës, trupi gjykues e konsideroi si deklarim të pasaktë⁴⁰, ndërsa faktin e pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit se në vitet 2006-2008 dhe 2011-2013 ka jetuar me ditë në shtëpinë e prindërve, për shkak të ndjekjes së studimeve në Shkollën e Magjistraturës e më pas për shkak të punësimit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, trupi gjykues e konsideroi si rrethanë të pamjaftueshme për të përcaktuar statusin e prindërve të subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur me të, pasi në këtë rast nuk u provua se ka ekzistuar marrëdhënie interesi mes tij dhe prindërve të tij. Komisioni nuk ka arsyetuar mbi ndonjë situatë të dyshuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit mbajnë pasuri të fshehur të tij, apo se pasuria në fjalë është përdorur për të fshehur ekzistencën e një marrëdhënieje që të çon në një situatë konflikti interesi të subjektit të rivlerësimit me persona të tjerë⁴¹.

61. Në lidhje me rrethanën tjetër të marrëdhënies kontraktore të shitblerjes së një automjeti, e krijuar midis subjektit të rivlerësimit me nënën e tij në vitin 2016, trupi gjykues vëren se Komisioni e ka konsideruar si rrethanë që i bën prindërit e subjektit të rivlerësimit persona të tjerë të lidhur, duke ngritur dyshime nisur nga raporti familjar. Konkretisht, Komisioni, në vendim është shprehur: “Komisioni, nisur nga faktet e pasqyruara në pikën 9.3 më sipër, por edhe nga marrëdhënia kontraktore e shitblerjes së automjetit të pasqyruar në pikën 2 më sipër, e krijuar midis subjektit dhe me nënën e tij, pasi ngriti dyshime nisur nga raporti familjar [...]”. Nga verifikimi i arsyetimit të vendimit në paragrafin 2 të tij, në lidhje me pasurinë automjet tip “Citroen C5”, blerë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, në vlerën 900.000 lekë, me palë shitëse znj. L. T., nëna e subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, por nuk ka arsyetuar në asnjë moment në lidhje me dyshime nisur nga raporti familjar. Në këtë kontekst, mbeten të paqarta se cilat janë dyshimet e Komisionit e në cilin drejtim orientohen ato.

Marrëdhënia kontraktuale mes subjektit të rivlerësimit dhe nënës së tij për shitblerjen e automjetit tip “Citroen C 5” në vitin 2016, konsiderohet një lidhje interesi, por referuar përcaktimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e tjerë të lidhur kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e dhurimit, huadhënies ose huamarrjes nga personat e tjerë të lidhur, trupi gjykues vlerëson se ajo nuk përmbush kriteret e parashikuara nga dispozita e sipërcituar, që të mund ta kualifikonte nënën e subjektit të rivlerësimit si person tjetër të lidhur me të, për më tepër në kushtet kur subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e palës blerëse në këtë marrëdhënie dhe ka rezultuar e provuar se pagesa e çmimit të kontratës së shitblerjes është bërë me transaksion bankar në shumën 900.000

³⁹ Vendim nr. 21/2020 (JR), datë 10.09.2020; vendim nr. 8/2020 (JR), datë 25.06.2020; vendim nr. 4/2021 (JR), datë 09.02.2021.

⁴⁰ Sipas arsyetimit të bërë në paragrafët 37-47 të këtij vendimi.

⁴¹ Ibid.

lekë, më datë 29.12.2016, nga subjekti i rivlerësimit drejt znj. L. T. (nëna e subjektit), fakt ky i konstatuar dhe pranuar nga Komisioni në vendim⁴².

Në këto rrethana, duke konstatuar gjithashtu se nuk rezultojnë nga aktet e administruara gjatë hetimit të dhëna apo dyshime që kjo pasuri, e cila ka qenë e regjistruar në emër të nënës së subjektit të rivlerësimit, është një pasuri e fshehur e tij⁴³, situatë e cila do të legjitimonte Komisionin të bënte hetime në këtë drejtim, trupi gjykues arrin në përfundimin se nëna e subjektit të rivlerësimit nuk mund të kualifikohet si person tjetër i lidhur, në përputhje me parashikimet ligjore që rregullojnë këtë status, e për pasojë, detyrimi që Komisioni i ka ngarkuar subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e gjendjeve të llogarive bankare në emër të saj në vitin 2016, është një detyrim në tejkalim të parashikimeve ligjore.

62. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, duke i konsideruar prindërit e subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur e duke e ngarkuar subjektin me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të kursimeve të tyre, nuk ka konstatuar në mënyrën e duhur dhe të plotë situatën faktike, e për pasojë ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Bazuar në këtë konkluzion, trupi gjykues çmon të panevojshëm shqyrtimin e pretendimeve të tjera të subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të prindërve të tij.

Ç. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale

63. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të tij të kryer nga KLP-ja⁴⁴ dhe në analizimin e fakteve të denoncuar nga publiku gjatë procesit të rivlerësimit. Komisioni, në vendim, lidhur me kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka arritur në konkluzionin se: “[...] gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara për moskryerje të hetimeve të plota, mosadministrimin e procedimeve penale, mosrealizimin e procedimeve penale në mënyrë efektive dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për sa kohë që jo në pak çështje të adresuara nga një numër i lartë i denoncuesve, u konkludua se vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit ishin prishur nga organet e gjyqësorit, madje edhe në mënyrë të përsëritur, i vlerëson ato si veprime dhe mosveprime të kryera, jo për shkak të paaftësisë profesionale të subjektit, por që dëshmojnë për sjellje të tij në mospërbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”⁴⁵.
Në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka ngritur në ankim pretendimet e tij, të cilat analizohen në vijim.

64. Në lidhje me dosjen nr. 2, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, pjesë e raportit të vlerësimit të KLP-së dhe e analizuar nga Komisioni në vendim, subjekti i rivlerësimit ka

⁴² Paragrafi 2.5 i vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

⁴³ Sipas informacionit të përcjellë në Komision nga DPShTRr, me shkresën nr. {***} prot., datë 02.05.2019, znj. L. T. ka blerë automjetin tip “Citroen C5” nga shitësi “{***}” në vlerën 8.000 euro, më datë 28.07.2015, dhe më pas ka regjistruar pronësinë e tij dhe ka marrë lejen e qarkullimit më datë 06.08.2015. Sipas kontratës të shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.10.2016, këtë mjet ia ka shitur subjektit të rivlerësimit në vlerën 900.000 lekë.

⁴⁴ KLP-ja ka përcjellë në Komision raportin e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.06.2019.

⁴⁵ Faqja 59 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

pretenduar se ka dhënë shpjegimet e tij gjatë hetimit administrativ në Komision, por këto shpjegime nuk janë konsideruar nga Komisioni.

Në lidhje me dosjen nr. 2, e cila i përket vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, datë 11.03.2015, regjistruar për veprën penale “Refuzimi për deklaram, mosdeklarami, fshehja ose deklarami i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal, Komisioni, në vendim⁴⁶, ka arritur në përfundimin: *Në referencë të legjislacionit që ndikon në vlerësimin e aftësive profesionale, rast pas rasti, trupi gjykues, në vlerësimin e kësaj çështjeje penale, arsyeton duke marrë në konsideratë përmbushjen e kërkesave të ligjit të aplikueshëm nr. 96/2016, neni 73. [...] trupi gjykues çmon se në çështjen penale, objekt i hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur analizimit dhe argumentimit të vendimit të pushimit të çështjes, dalë pas një vendimi për të cilin vetë subjekti kishte lënë detyrë për t’u përmbushur, por që nuk rezultoi i tillë.*

65. Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar në lidhje me këtë procedim penal, se kallëzimi penal i ILDKPKI-së është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 13.01.2015. Dosja i është ngarkuar për kryerjen e verifikimeve oficerit të Policisë Gjyqësore dhe, sipas urdhrat të Prokurorit të Përgjithshëm, vendimet e mosfillimit, kur ishte rasti, duhet të merreshin brenda një afati 30-ditor nga dita e regjistrimit të kallëzimit penal. Nga aktet e dosjes, rezulton që verifikimet janë kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore tej afatit 30-ditor dhe relacioni është përpiluar prej tij në datën 27.02.2015. Në këto rrethana, subjekti kishte vendosur regjistrimin e procedimit dhe pushimin e tij, pasi kishte bindjen se pushimi i procedimit penal ishte i bazuar në ligj dhe prova. Vendimi i është njoftuar ILDKPKI-së në cilësinë e kallëzuesit, më datë 27.03.2015, dhe nuk rezultoi që ndaj tij të jetë ushtruar ankim.
66. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht, dosja e procedimit penal nr. {***} të vitit 2015, trupi gjykues konstaton se:
- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 13.01.2015, ka regjistruar materialin kallëzues nr. {***}, mbi bazën e kallëzimit penal të depozituar nga ILDKPKI-ja, ndaj shtetasit I. K., për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal. Ky material kallëzues i ka kaluar për verifikim subjektit të rivlerësimit më datë 26.01.2015. Materiali kallëzues i ka kaluar oficerit të Policisë Gjyqësore E. P., i cili në relacionin e datës 27.02.2015, ka sugjeruar mosfillimin e procedimit penal.
 - Subjekti i rivlerësimit, më datë 10.03.2015, ka marrë vendimin për regjistrimin e procedimit penal, duke argumentuar se “për të grumbulluar të dhëna të nevojshme, është e domosdoshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore që bëjnë të nevojshëm regjistrimin e procedimit penal”.
 - Më datë 11.03.2015, nga subjekti i rivlerësimit është marrë vendimi për pushimin e procedimit penal. Në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka analizuar elementet e kundërvajtjes penale të parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal dhe zbatimin e saj në rrethanat e rastit konkret, duke vendosur pushimin e procedimit penal.
 - Në raportin e vlerësimit të KLP-së është konstatuar: “Për shkak se ka kaluar afati 30-ditor për kryerjen e veprimeve verifikuese, subjekti i rivlerësimit, më datë 10.03.2015, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal. Veprimet verifikuese, për shkak ngarkese, nuk janë mundur të kryhen brenda afatit 30-ditor. Për këtë shkak është vendosur regjistrimi i procedimit dhe më pas është vendosur pushimi i tij”.

⁴⁶ Faqja 35 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

- Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjen: “Duket sikur regjistrimi i këtij procedimi penal është bërë formalisht, pasi nuk është kryer asnjë veprim hetimor për të konkluduar në lidhje me përfundimin e hetimit”.

Në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pushimi i procedimit penal nr. {***} i vitit 2015, vetëm një ditë pas regjistrimit të tij, ka ardhur si pasojë e nevojës për të shmangur shkeljen e afateve procedurale.

67. Në analizë të përmbajtjes së vendimit të pushimit të procedimit penal, të akteve të administruara në dosjen e procedimit penal, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në ankim, trupi gjykues vëren se në udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 21.11.2005, “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale” [i ndryshuar me udhëzimin nr. {***}, datë 27.10.2006 dhe me udhëzimin nr. {***}, datë 19.06.2021], konkretisht në pikat 2.1 dhe 2.2 të tij, përcaktohet se: “2.1 Në rastet kur me gjendjen e akteve prokurori vlerëson se ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, vendos mosfillimin e procedimit, por jo më vonë se 10 ditë nga mbërritja e kallëzimit apo referimit të veprës penale. Gjatë kësaj periudhe nxitet të bëhet një minimum verifikimesh nëse ka nevojë për një gjë të tillë, në të kundërt vendoset regjistrimi i procedimit. 2.2 Në raste të veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar në pikën 2.1 të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 30 ditë”.
68. Sipas këtyre përcaktimeve, afati maksimal brenda të cilit prokurori mund të vendoste për mosfillimin e procedimit penal, ishte brenda 30 ditëve nga data e mbërritjes së kallëzimit apo referimit të veprës penale. Nga argumentet e përdorura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të shkakut të ankimit, trupi gjykues vëren se vendimmarrja e tij për pushimin e procedimit penal, [vetëm një ditë pas vendimmarrjes për regjistrimin e këtij procedimi, pa kryer veprimet hetimore të cilat ishin cilësuar prej tij si të nevojshme dhe që arsyetonin regjistrimin e procedimit], dukshëm është gjetur si “zgjidhje e detyruar” për të shmangur moszbatimin e afatit të përcaktuar në udhëzimin e sipërcituar të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi aktet e përcjella nga kallëzuesi dhe rezultatet e dala nga veprimet verifikuese të kryera nga oficeri i Policisë Gjyqësore, qartësisht tregojnë se kryerja e veprimeve të tjera hetimore ishte e panevojshme. Në analizë të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit, në vendimin e pushimit të procedimit penal do të duhej të kishte arsyetuar se përse erdhi ndërmarrja e një akti të shpejtë, trupi gjykues çmon se një arsyetim i tillë nuk do t’u sillte asnjë argument të shtuar arsyeve për pushimin e procedimit penal, të cilat janë argumentuar në vendim nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes. Mungesa e arsyetimit në vendimin e pushimit të procedimit penal, në lidhje me “shpejtësinë e marrjes së tij”, apo edhe nxjerrja e vendimit për regjistrimin e procedimit penal në kufijtë e një akti formal në mungesë të ndërmarrjes së veprimeve hetimore, të cilat në fakt kanë qenë të panevojshme, nuk mund të konsiderohet si një shkelje që duhet të mbahet në konsideratë në kuptim të nenit 73, të ligjit nr. 84/2016, pasi në rastin konkret, trupi gjykues çmon se qartësia dhe kuptueshmëria e aktit të prokurorit nuk është cenuar.
69. Në lidhje me dosjen nr. 3, si një nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, pjesë e raportit të vlerësimit të KLP-së dhe e analizuar nga Komisioni në vendim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *vendimi i pushimit të këtij procedimi penal është marrë pas analizës së akteve që ndodheshin në dosje dhe vlerës së dhënë provave e akteve, prej tij si prokuror i çështjes.*

Në lidhje me dosjen nr. 3, e cila i përket vendimit për pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, datë 11.09.2014, të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni, në vendim, ka konstatuar se krahas përshkrimit të kësaj çështjeje në raportin profesional, si një ndër dosjet e shortuara, kallëzuesi K. L. ka depozituar edhe dy denoncime në Komision, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Pas përfundimit të hetimit administrativ, Komisioni, në vendim, ka arritur në përfundimin se “në konstatim të fakteve se subjekti nuk ka arsyetuar dhe argumentuar veprimet dhe mosveprimet hetimore, për të konkluduar në një vendim të qartë, të thelluar dhe të analizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjen hetimore, çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimin e bërë në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kërkesat e ligjit nr. 96/2016”⁴⁷.

70. Në lidhje me këtë konkluzion të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ka argumentuar se lidhur me mosarsyetimin me akt të shkruar të mosmarrjes në pyetje të një shtetasi, referuar vendimit të pushimit të procedimit, mundet që pyetja e personit të mos ndikonte në rezultatin e përfundimit të çështjes. Nga aktet e dosjes, rezulton se ankuesi K. L. është njoftuar nga ana e subjektit të rivlerësimit si prokuror i çështjes, për vendimin e pushimit dhe që nga ajo ditë e deri aktualisht, nuk rezulton të jetë ankimuar vendimi i pushimit nga K. L. si person i interesuar për çështjen. Subjekti i rivlerësimit shpjegon gjithashtu se, nisur nga ngarkesa e madhe e punës së tij si prokuror në vite dhe natyra e çështjeve të hetuara prej tij, mundet që vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve të jetë përpiluar në mënyrë që aktet të ishin të vlefshme proceduralisht dhe vendimmarrja të kryhej brenda afateve ligjore.
71. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht, dosja e procedimit penal nr. {***} të vitit 2014, trupi gjykues konstaton si vijon.
- Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 31.10.2012, ka regjistruar procedimin penal nr. {***}, mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasit K. L., për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, e parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, ndaj shtetasve I. A. dhe L. K. Regjistrimi është kryer nga prokurorja E. C. Ky procedim penal, me vendimin e datës 10.12.2013 të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. P. F., është bashkuar me një procedim tjetër penal, pasi po hetohej edhe për një fakt tjetër penal në ngarkim të shtetasit I. A. me kallëzim të shtetasve M., B. dhe H. P. Hetimi i ka kaluar prokurorit A. G. Ndër të tjerët, i është komunikuar akuza dhe të pandehurës L. K. me cilësinë e noteres, për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 186/3-25 i Kodit Penal dhe është përpiluar kërkesa për gjykimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2012.
 - Drejtuesi i prokurorisë, z. P. F., më datë 14.03.2014, ka marrë vendim për shfuqizimin e pjeshëm të vendimit të dërgimit të çështjes për gjykim, për sa i përket të pandehurës L. K., për të cilën ka vendosur të vazhdojnë hetimet [të pyetet shtetasja L. K. si person nën hetim ose e pandehur, si dhe të pyetet shtetasi K. L. se kur është njohur me noteren, nëse ka kryer më parë akte noteriale të kjo notere] dhe ato të kryhen nga prokurori Ndini Tavani [subjekti i rivlerësimit].
 - Subjekti i rivlerësimit, më datë 14.03.2014, ka vendosur zgjatjen e hetimeve nga data 14.03.2014 deri më 14.06.2014, me arsyetimin se duhen kryer disa veprime hetimore të cilat janë cituar edhe në vendimin e drejtuesit të prokurorisë, për ndarjen e çështjes, konkretisht, për të thirrur kallëzuesin K. L., si dhe për të administruar dokumentacionin që është përdorur nga personat për identifikimin para noterit me qëllim hartimin e akteve objekt hetimi etj.

⁴⁷ Faqja 38 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019 të Komisionit.

Gjatë kësaj periudhe, rezulton të jetë kryer nga subjekti i rivlerësimit, pyetja e noteres L. K., më datë 03.06.2014, në cilësinë e të pandehurës. Pyetja e kallëzuesit K. L. me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit është bërë nga oficeri i Policisë Gjyqësore më datë 21.05.2014.

- Më datë 14.06.2014, subjekti i rivlerësimit ka zgatur sërish kryerjen e hetimeve deri në datën 14.09.2014, me arsyetimin se është e nevojshme pyetja e shtetasit K. L. dhe e shtetasit I. A., çështja e të cilit, sipas akteve, kishte kaluar për gjykim pranë organeve të gjyqësorit me cilësinë e të pandehurit.

- Në datën 11.09.2014, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal ndaj të pandehurës L. K., bazuar në nenin 328, shkronjat “b” e “dh” të Kodit të Procedurës Penale⁴⁸.

72. Në analizë të konstatimeve të mësipërme, në raport me konkluzionin e Komisionit, si dhe në mungesë të argumenteve konkrete të subjektit të rivlerësimit në ankim, në lidhje me këtë konkluzion⁴⁹, trupi gjykues vëren se neni 324 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se⁵⁰:

1. *Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj.*

2. *Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet. Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cenuar afatet e kohëzgjatjes së paraburgimit [...]*

Në zbatim të kësaj dispozite në rastin konkret, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në asnjë prej vendimeve të marra prej tij, se cila prej kërkesave të nenit 324, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale është përmbushur për të justifikuar zgjatjen e afateve të hetimit, në drejtim të argumentimit të kompleksitetit të çështjes, apo të pamundësisë objektive për të përfunduar hetimin brenda afatit të parë tremujor. Në vendimin e dytë të zgjatjes së hetimeve, subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar nevojën e zgjatjes së hetimit për rimarrjen në pyetje të kallëzuesit K. L. Në arsyetimin e vendimit të pushimit, subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar se përse nuk pyeti shtetasin I. A., në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprën penale dhe që ishte dërguar për gjykim me cilësinë e të pandehurit nga prokurori i mëparshëm, ashtu siç kishte vendosur në vendimin e dytë për zgjatjen e afateve të hetimit.

73. Për pasojë, trupi gjykues çmon se është i drejtë konkluzioni i Komisionit se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit paraqet mangësi në drejtim të qartësisë të pjesës arsyetuese të vendimit, në përputhje me nenin 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi në vendimmarrjet e tij në këtë procedim penal, subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar në lidhje me arsyet e zgjatjes së afateve të hetimit dhe moskryerjes së veprimeve hetimore sipas vendimmarrjes së tij.

74. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit vlerësimi i Komisionit për denoncimin e shtetasit A. R. për procedimin penal nr. {***} të vitit 2017, nuk qëndron, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁵¹, ka arritur në konkluzionin: [...] ndërmarrja e veprimeve të subjektit të rivlerësimit

⁴⁸ Subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në pjesën arsyetuese të vendimit të pushimit të procedimit penal, se nga të gjitha hetimet e kryera, arrihet në përfundimin se veprimet e kryera nga ana e së pandehurës në cilësinë e noteres, gjatë lidhjes së kontratave noteriale, nuk janë kryer me dashje, me qëllim për t'i falsifikuar ato.

⁴⁹ Në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ, në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim si në ankim.

⁵⁰ Dispozita në fuqi, në kohën e marrjes së vendimeve nga subjekti i rivlerësimit lidhur me procedimin penal objekt vlerësimi.

⁵¹ Faqet 43-44 të vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

për të zëvendësuar oficerin e Policisë Gjyqësore vetëm përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, në një kohë që nga i pandehuri një kërkesë e tillë ishte shprehur në kohë, cenon rolin dhe njëanshmërinë e tij në funksion të ushtrimit të detyrës. [...] subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016 dhe rregulloren për "Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve", miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjera, rasti trajtohet si zgjidhje e gabuar ligjore, parashikuar në pikën 1.3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje. [...] subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbushë në kohë një prej aftësive të parashikuara në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si element që vlerëson aftësitë profesionale të prokurorit, "aftësinë për të mbledhur provat e kërkuara me ligj".

75. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, ka parashtruar në ankim argumentet si vijojnë.

(i) Vetë Komisioni ka pranuar se kthimi për herë të parë i kërkesës për pushim është vendosur në kundërshtim me ligjin nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi njoftimi i akteve për viktimën ndodhet në dosje. Në këtë vendim, Gjykata e Apelit nuk ka lënë asnjë detyrë përveç njoftimit të viktimës.

(ii) Disponimi i Gjykatës së Apelit se prokurori duhet t'i kërkojë kallëzuesit prova dhe dokumente që i shërbejnë hetimit, është abstrakt dhe i pakuptimtë, i vendosur vetëm për të përligjur rrëzimin e kërkesës për pushimin e procedimit penal, pasi kallëzuesi ka pasur të gjitha mundësitë t'i paraqesë prokurorit prova dhe akte, ashtu siç edhe ka vepruar.

(iii) Pyetja e kallëzuesit dhe e përfaqësuesit të tij, e lënë si detyrë nga Gjykata e Apelit, ishte ezauruar tashmë në kohë nga subjekti i rivlerësimit dhe nga ana e kallëzuesit nuk rezulton të jetë kërkuar ripyetja e tij, apo e personave të tjerë që kanë dijeni për rrethanat e hetimit e, në këto kushte, subjekti i rivlerësimit është i bindur se pyetja e këtyre personave nuk do të sillte asnjë risi për çështjen. Për rrjedhojë, pyetja e kallëzuesit dhe e babait të tij dhe kërkimi prej tyre i provave të reja, në kuadër të detyrave të lëna nga gjykata, me gjithë sforcimin e Komisionit për t'u trajtuar si veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin nr. 96/2016 dhe urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, jo vetëm nuk qëndron, por nuk ka asnjë lidhje me çështjen konkrete dhe veprimet hetimore që duhet të ishin kryer, kjo edhe pse njëra nga trupat gjykuese që ka gjykuar këtë kërkesë, ka pranuar kërkesën e prokurorit për pushimin e çështjes.

(iv) Vlerësimi i Komisionit është jo i drejtë, pasi ka të bëjë me një çështje që deri në ditën e dhënies së vendimit ka qenë duke u hetuar nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes, për rrjedhojë, në ndalesë për t'u shqyrtuar sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës.

76. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht, dosja e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017, trupi gjykues konstaton se:

76.1 Subjekti i rivlerësimit, me urdhrin e regjistrimit të datës 13.11.2017, ka vendosur regjistrimin e procedimit penal me nr. {***} të vitit 2017, mbi kallëzimin e shtetasit A. R.

76.2 Në përfundim të hetimeve paraprake, oficeri i Policisë Gjyqësore, në relacionin drejtuar subjektit të rivlerësimit, ka sugjeruar pushimin e procedimit penal.

76.3 Në datën 28.12.2017, subjekti i rivlerësimit ka hartuar kërkesën për pushimin e procedimit penal, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 26.02.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017. Mbi ankimin e kallëzuesit, me vendimin nr. {***}, datë 30.04.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe kthimin e akteve, me arsyetimin se nga akuza nuk janë respektuar dispozitat e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, për komunikimin e të dëmtuarit në lidhje me rezultatin e hetimeve.

76.4 Pas kryerjes së njoftimit të kallëzuesit me rezultatin e hetimeve, prokurori [subjekti i rivlerësimit], më datë 04.07.2018, ka proceduar sërish me kërkesën për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 08.10.2018, ka vendosur kthimin e akteve të hetimeve paraprake të procedimit penal, për kryerjen e hetimeve të plota, duke i caktuar prokurorisë një afat prej 60 ditësh. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim nga organi i prokurorisë dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

76.5 Në datën 21.03.2019, subjekti i rivlerësimit, në zbatim të vendimit të sipërcituar, ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë.

76.6 Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjen: *Duket se ju nuk keni njoftuar palën e dëmtuar; nuk keni kryer hetime të plota për rastin, veprime të konstatuara dhe të lëna në fuqi nga gjykatat.*

Në shpjegimet e dhëna në Komision mbi rezultatet e hetimit administrativ në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit përtej argumenteve të dhëna në ankim, ka argumentuar se: “Nga aktet e fashikullit të procedimit penal, rezulton se gjetja e Gjykatës së Apelit nuk qëndron, pasi në aktet e procedimit penal, në faqet 89, 90, 91, ndodhet njoftimi i përfundimit të hetimeve kundrejt nënshkrimit të kallëzuesit A. R.”.

77. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike të sipërcituar, në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vetë Komisioni ka pranuar se kthimi për herë të parë i kërkesës për pushim është vendosur në kundërshtim me ligjin nga ana e Gjykatës së Apelit, pasi njoftimi i akteve për viktimën ndodhet në dosje dhe është nënshkruar prej tij, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim, është shprehur: *Trupi gjykues, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, akteve të administruara në fashikullin penal dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se qëndron pretendimi i subjektit lidhur me kthimin e akteve të çështjes penale nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {***} regj. them., datë 30.04.2018, për shkak të mungesës së njoftimit të përfundimit të hetimeve për kallëzuesin (viktimën), pasi nga aktet rezulton, sikurse është shprehur edhe subjekti, se njoftimi është kryer dhe se ky fakt pasqyrohet në faqet 89, 90 dhe 91 të fashikullit të hetimit.*

Por, më pas, Komisioni ka vijuar vlerësimin, duke arsyetuar: *Por nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se nuk qëndron pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit lidhur me kthimin për të dytën herë të akteve si nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe po ashtu edhe nga ajo e Apelit, ku ndër të tjera është lënë detyrë që krahas pyetjes për kallëzuesin dhe përfaqësuesin e tij, të merren edhe dokumente dhe prova që i shërbejnë hetimit. Subjekti, në parashtrimet e tij, nuk ka dhënë asnjë argument nëse në hetimet e kryera pas kthimit për herë të parë të akteve të kishte kërkuar prova dhe dokumente që i shërbenin hetimit dhe, për pasojë, duket se ky qëndrim i gjykatës në kthimin e akteve ka qenë i drejtë - për të arritur më pas në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016 dhe rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjera, rasti trajtohet si zgjidhje e gabuar ligjore, parashikuar në pikën 1.3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje dhe se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbushë në kohë një prej aftësive të parashikuara në nenin 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si element që vlerëson aftësitë profesionale të prokurorit, “aftësinë për të mbledhur provat e kërkuara me ligj”.*

78. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim të këtij arsyetimi dhe konkluzionit të Komisionit, në raport me situatën faktike të pasqyruar si më sipër në këtë vendim, trupi gjykues vëren se në vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 30.04.2018, që ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 26.02.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e akteve [për herë të parë], detyra e vetme që i është lënë prokurorisë ka qenë njoftimi i kallëzuesit për përfundimin e hetimeve, por siç është konstatuar e pranuar nga vetë Komisioni, njoftimi i kallëzuesit gjendej i pasqyruar në fashikullin e hetimit, për pasojë zbatimi i kësaj detyre nga subjekti i rivlerësimit ka qenë një rinjoftim formal i kallëzuesit, në përmbushje të detyrës së lënë në vendimin e Gjykatës së Apelit. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në zbatim të këtij vendimi, nuk kishte detyrimin të kryente veprime të tjera hetimore, përtej atyre të lëna detyrë nga Gjykata e Apelit, për rrjedhojë vlerësimi i Komisionit nuk mbështetet në përmbajtjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 30.04.2018.
79. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se “subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjera, rasti trajtohet si zgjidhje e gabuar ligjore, parashikuar në pikën 1.3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje”, trupi gjykues vëren se akti i sipërcituar në nenin 16, “Zgjidhje të gabuara ligjore”, pika 1.3 parashikon: *1. Zgjidhje të gabuara ligjore konsiderohen rastet kur: [...] 1.3 Vendimi i pushimit të çështjeve ose vendimi i mosfillimit të procedimit është prishur nga gjykata ose është shfuqizuar nga prokurori më i lartë dhe për këto çështje është ngritur akuzë në gjykatë, e cila ka deklaruar fajësinë e personave të akuzuar.* Rrethanat e rastit konkret nuk plotësojnë kushtet e parashikuara nga kjo dispozitë për t’u kualifikuar si zgjidhje e gabuar ligjore, pasi gjykata nuk ka deklaruar fajësinë e ndonjë personi, pasi çështja është ende nën hetim. Në këto kushte, është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se vlerësimi i Komisionit për zgjidhje të gabuar ligjore nuk lidhet me çështjen konkrete. Pyetja e kallëzuesit dhe e përfaqësuesit të tij, si dhe marrja e dokumenteve dhe provave që i shërbejnë hetimit, janë detyra të lëna me vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 08.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për kthimin e akteve të hetimeve paraprahe të procedimit penal nr. {***} të vitit 2017. Në lidhje me disponimin e këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar se detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. {***}, datë 21.11.2018, në vlerësimin e tij nuk do të sillnin asnjë risi për çështjen, pasi shtetasi A. R. është pyetur më datë 31.10.2017 dhe në kallëzimin e shtetasit A. R. nuk është përshkruar pretendimi në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e të kallëzuarve. Nga verifikimi i dosjes së procedimit penal nr. {***}, të vitit 2017, rezulton se këto veprime hetimore janë kryer nga subjekti i rivlerësimit, ashtu siç janë referuar prej tij.
80. Në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar: *Në dosjen hetimore ndodhet dhe një kërkesë drejtuar drejtuesit të Prokurorisë, znj. E. I., për përjashtimin e prokurorit Ndini Tavani dhe oficerit të Policisë Gjyqësore Gj. N. nga hetimi i çështjes penale nr. {***} i vitit 2017, por nuk konstatohet marrja e një vendimi nga ana e saj në lidhje me këtë kërkesë.* Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: *Më datë 10.04.2019, në organin procedues është administruar një kërkesë e përsëritur e shtetasit A. R. për zëvendësimin e prokurorit të çështjes dhe oficerit të Policisë Gjyqësore. Me vendimin e datës 02.09.2019, kam vendosur zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore dhe, referuar vendimit të gjykatës, ka urdhëruar ndryshimin e cilësimit juridik, duke vazhduar hetimet për veprën penale të ekspertimit të rremë, sipas nenit 309 të Kodit Penal. Në përfundim të këtij sqarimi, ju bëj me dije se çështja është ende nën hetim dhe kam bindjen e bazuar në ligj se nuk kam asnjë rrethanë*

objektive apo subjektive për të hequr dorë nga hetimet e këtij procedimi penal. Referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit E, konsideroni faktin që kjo çështje është në shqyrtim, në fazën e hetimeve. Në vendim, Komisioni ka arritur, ndër të tjera, në konkluzionin se: *Trupi gjykues çmon se ndërmarrja e veprimeve të subjektit të rivlerësimit për të zëvendësuar oficerin e Policisë Gjqësore vetëm përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, në një kohë që nga i pandehuri një kërkesë e tillë ishte shprehur në kohë, cenon rolin dhe njëanshmërinë e tij në funksion të ushtrimit të detyrës.* Trupi gjykues, në vlerësim të situatës faktike si më sipër, çmon se, bazuar në nenin E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, konkluzioni i Komisionit në lidhje me veprimet procedurale të subjektit të rivlerësimit, nuk mund të jetë objekt rivlerësimi, pasi çështja ishte ende nën shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit, në fazën e analizuar nga Komisioni⁵².

Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

81. Në lidhje me denoncimin e shtetasit E. S., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se *vlerësimi i Komisionit për faktet e denoncuar nga ky shtetas nuk qëndron, pasi çështja e analizuar vijonte të ishte në hetim dhe gjykim, në kohën e dhënies së vendimit për procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, duke u analizuar në këtë mënyrë nga Komisioni, në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.*

Nga verifikimi i përmbajtjes së vendimit të Komisionit, trupi gjykues konstaton se ky i fundit, në lidhje me denoncimin e shtetasit E. S., ka vlerësuar se: “Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij, kryesisht pa dhënë argumente bindëse për kohën e gjatë të rezultuar mes kryerjes së dy veprimeve procedurale të kryera nga ana e tij, ka cenuar procesin e rregullt në dobi dhe interes të denoncuesit, nuk është treguar efektiv në përmbjlljen e fashikullit hetimor dhe, për pasojë, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, por edhe të kriterëve të përcaktuara në rregulloren “Për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër kriteret dhe kërkesat e përcaktuara si bazë për vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit, është edhe efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimi i një procedimi penal”⁵³.

82. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, ka parashtruar në ankim argumentet si vijojnë.

(i) Çështja penale nr. {***}/2017, në ngarkim të shtetasit E. S., vijonte të ishte në hetim dhe gjykim, në kohën e dhënies së vendimit për procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, duke u analizuar në këtë mënyrë nga Komisioni, në kundërshtim me nenin E të Aneksit të Kushtetutës.

(ii) Sipas nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, përpilimi i kërkesës për pushimin e çështjes apo procedimit penal, edhe pse renditet si akt procedural pas njoftimit të akteve të pandehurit dhe të dëmtuarit, nuk lidhet me afat të caktuar për përpilimin e një akti të tillë.

83. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, konkretisht, dosja e çështjes penale nr. {***} të vitit 2017, në ngarkim të shtetasit E. S., trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në drejtim të zgjidhjes së çështjes, ka ndërmarrë veprimet hetimore si vijojnë.

⁵² Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 28.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale, i paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, kjo gjykatë me vendimin nr. {***} regj. themeltar, datë 24.05.2021, ka vendosur pushimin e çështjes penale me nr. {***}, të vitit 2017. Vendimi është ankimuar dhe dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë.

⁵³ Faqja 46 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

83.1 Më datë 12.06.2018 është kryer veprimi i eksperimentit hetimor, më pas në datë 13.06.2018 është pyetur personi nën hetim E. S.

83.2 Në datën 14.12.2018, është përpiluar akti për përfundimin e hetimeve, sipas të cilit është konkluduar se, me gjithë hetimet e kryera, nuk provohet kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 84, 283/1 dhe 278 të Kodit Penal nga personi nën hetim dhe, për sa më sipër, në bazë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penal, mbrojtësit i është komunikuar e drejta për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje të tyre, të paraqesë brenda 10 ditëve memorie e dokumente, si dhe t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë.

83.3 Subjekti i rivlerësimit ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. {***} të vitit 2017 në ngarkim të shtetasit E. S., në datën 10.05.2019, në atë nr. {***} të vitit 2019, për zbulimin e autorit për veprat penale “Kanosje”, “Prodhim dhe shitje të narkotikëve” dhe “Prodhim dhe shitje të armëve luftarake, municioneve”, parashikuar nga nenet 84, 283/1 dhe 278 të Kodit Penal, si dhe në po këtë datë ka hartuar kërkesën për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2017.

83.4 Në kërkesë-memorien e paraqitur nga personi nën hetim më datë 03.04.2018, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm [kërkesë e cila i është dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerësim, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.05.2018], është pretenduar njëanshmëria e veprimeve të oficerit të Policisë Gjyqësore, E. Gj., për konflikt interesi të hapur, për shkak të lidhjeve të këtij të fundit me z. I. Xh., me të cilin personi nën hetim ishte në konflikt për çështje pronësie dhe pretendonte se ngjarja për të cilën po hetohej ishte inskenuar nga z. Xh.

83.5 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtat argumente që ka parashtruar edhe në ankim. Në këto shpjegime, subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin se procedimi i ndarë, pas vendimit të tij për zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore, për të cilin ka pasur pretendime shtetasi E. S., është dërguar për veprime të mëtejshme në Komisariatit e Policisë Nr. 4.

84. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në këtë shkak ankimi, në raport me situatën faktike si më sipër dhe konkluzionet e Komisionit, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka informuar Komisionin se kërkesa për pushimin e kësaj çështjeje ishte duke u shqyrtuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe seanca gjyqësore e radhës ishte caktuar më datë 09.10.2019⁵⁴.

Në këto kushte, rezulton se kërkesa për pushimin e çështjes penale nr. {***} e vitit 2017, ka qenë në shqyrtim gjyqësor në kohën e kontrollit dhe vlerësimit të kryer nga Komisioni, për pasojë ky i fundit ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, të parashikuar nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës: *Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.* Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se kontrolli i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit për këtë çështje është kryer nga Komisioni në tejkallim të kompetencës kushtetuese dhe ligjore, duke e bërë pretendimin e subjektit të rivlerësimit të drejtë e të bazuar në ligj. Ndalimi i vlerësimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit ndaj çështjeve që

⁵⁴ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 28.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, kjo gjykatë, më datë 22.01.2020, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të mbyllura të kërkesës penale nr. {***} akti, datë regj. 03.06.2019, duke vendosur: *“Pushimin e çështjes penale ndaj personit nën hetim E.S., i dyshuar për veprat penale të “Kanosjes”, “Mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyes dhe municionit” dhe “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”, të parashikuara nga nenet 84, 278 dhe 283 të Kodit Penal”. Kundër këtij vendimi është paraqitur ankimi nga shtetasi E.S. dhe çështja është në Gjykatën e Apelit Tiranë për shqyrtimin e ankimit.*

janë në shqyrtim, sipas pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ka synuar shmangien e paragjykimit të organeve të rivlerësimit ndaj zgjidhjes së një çështjeje në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit e njëkohësisht dhe shmangien e paragjykimit të çështjes e dhënies së zgjidhjeve të gabuara nga subjekti i rivlerësimit nën “presionin” apo ndikimin e procesit të rivlerësimit. Në rastin konkret, Komisioni, në konstatimin në vendim se *subjekti kishte bërë zëvendësimin e oficerit të Policisë Gjyqësore vetëm pasi ishte njohur me rezultatet e hetimit administrativ*, ka dëshmuar pikërisht veprimin e subjektit të rivlerësimit në çështjen që kishte në shqyrtim, nën ndikimin e vlerësimit për shkak të procesit të rivlerësimit.

85. Në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit se: “[...] mosndërmarrja e veprimeve të tjera hetimore në kohën e duhur, pra, paralelisht me hetimin e themelit, por vetëm pas ndarjes së çështjes në datën 10.05.2019, kur edhe ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në këtë drejtim, bie në kundërshtim me rolin dhe përmbushjen e detyrave të prokurorit me profesionalizëm, efektivitet dhe paanshmëri”, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se:
- (i) veprimet procedurale janë kryer në kontroll të gjykatës së hetimeve paraprake, sipas akteve të dosjes;
 - (ii) vlerësimi i strategjisë së hetimit çmohet nga prokurori i çështjes si organ për ushtrimin e ndjekjes penale dhe Komisioni nuk mund të hyjë në interpretimin dhe logjikën e prokurorit në një çështje konkrete;
 - (iii) shtetasi E. S. ka qenë në cilësinë e personit nën hetim dhe, si i tillë, veprimet hetimore janë shtrirë për të provuar nëse veprat penale ishin kryer ose jo nga ai person;
 - (iv) kryerja e të gjitha veprimeve hetimore, të vendosura nga subjekti i rivlerësimit si prokuror i çështjes, provon se ai ka ndjekur dhe respektuar në hetimin e këtij procedimi penal, nevojën për ushtrimin e ndjekjes penale në funksion të provave, si dhe të drejtat dhe liritë e personit;
 - (v) bashkë me kërkesën për pushimin e çështjes, subjekti ka çmuar dhe ndarjen e procedimit penal, duke pasur bindjen se ka qenë koha e duhur, për të mos paragjykuar hetimet që kryheshin ndaj këtij personi, përfundimin e hetimeve paraprake.
86. Trupi gjykues vlerëson se edhe për këtë çështje, Komisioni ndodhej në kushtet e pengesës ligjore për vlerësimin e subjektit, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Pavarësisht këtij vlerësimi, i cili e bën të panevojshëm analizimin e pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues çmon të japë një vlerësim për to, në kuadër të shqyrtimit të plotë të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit. Në vijim, trupi gjykues i gjen të drejta pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë vlerësimi i Komisionit implikon drejtpërdrejt bindjen e brendshme e logjikën e subjektit të rivlerësimit mbi vlerësimin e provave dhe ecurinë e hetimit, për të vendosur momentin e duhur procedural për ndarjen e çështjes dhe vijimin e hetimeve në lidhje me pretendimin e personit nën hetim për inskenimin e çështjes në ngarkim të tij, pra me atë aspekt të aftësive të magjistratit që nuk mund të vlerësohet si matës i aftësive të tij profesionale në kuadër të këtij procesi. Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje në nenin 44, paragrafi 1 i ligjit nr. 84/2016, i cili referon te kriteret e ligjit nr. 96/2016, si kritere që duhen analizuar në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjekteve, ligj i cili në nenin 73, pika 4, ndalon vlerësuesin të çmojë aftësitë duke gjykuar korrektësinë e themelin e çështjes dhe duke zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.
87. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se konkluzionet e Komisionit, pas kontrollit dhe vlerësimit të çështjes, nuk mund të shërbejnë si gjetje të cilat duhet të analizohen në këndvështrim të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.
88. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit, *për denoncimin e shtetasit V. Ç. për procedimin penal nr. {***/2018, Komisioni ka bërë një vlerësim alogjik e abstrakt, duke përdorur terma të*

*përgjithshëm që nuk ndërliidhen në asnjë moment me çështjen, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar duke u mbështetur në disponimin e vendimit nr. {***}, datë 02.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili, pas kërkesës së prokurorisë⁵⁵ për heqjen dorë nga ankimi, është lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 06.02.2019, të Gjykatës së Apelit Tiranë.*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në vendimin nr. {***}, datë 02.11.2018, është shprehur: “[...] Gjykata çmon se kërkesa e prokurorisë për pushimin e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, është rezultat i një interpretimi të gabuar të ligjit material dhe procedural. [...] gjykata vlerëson se pretendimi i prokurorisë se vërtetësia e dokumentit që pretendohet i falsifikuar, duhet të bëhet në rrugë civile duke iu drejtuar me padi për konstatim të pavlefshëm të kësaj kontrate, lidhur ndërmjet palëve të sipërpërkshkruara, pasi është një marrëdhënie juridiko-civile, jo vetëm që është i pabazuar në provat e administruara gjatë gjykimit, por është dhe rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit procedural civil e penal. Kjo për faktin pasi nga ana e viktimës nuk pretendohet falsiteti i kontratave të shitjes, por pretendohet përdorimi i një dokumenti të falsifikuar, sikurse është vendimi nr. {***}, datë 16.09.2000, i KKKP-së Tiranë, falsiteti i të cilit është provuar tashmë me vendimin nr. {***}, datë 09.09.2011, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar:

“Gjykata vlerëson se mbi bazën e provave të administruara, rezulton se ka prova të mjaftueshme që provojnë se i kallëzuari F. Ll. e ka konsumuar figurën e veprës penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Megjithatë, në rastin konkret, gjykata nuk mund të urdhërojë formulimin e akuzës dhe paraqitjen direkt të kërkesës për dërgim në gjykim, pasi duhet të kryhen dhe disa veprime të domosdoshme hetimore për ta përgatitur çështjen për gjykim. Kështu, nga ana e prokurorisë, duhet të kryhen këto veprime hetimore:

(i) të regjistrohet në regjistrin e veprave penale si person nën hetim emri i shtetasit F. Ll., në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale;

(ii) pyetjen e shtetasit F. Ll. si person nën hetim, në zbatim të nenit 296 Kodit të Procedurës Penale, në praninë e detyrueshme të një mbrojtësi, në respektim të shkronjës “ë” të pikës 1 të nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale;

(iii) njoftimin e shtetasi F. Ll. (pasi të merret i pandehur);

(iv) në zbatim të pikës 4 të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, të njoftohet i pandehuri se ka të drejtë që brenda 10 ditëve të paraqesë memorie dhe dokumente, t’i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje. Kur i pandehuri kërkon të merret në pyetje, prokurori është i detyruar të procedojë me pyetjen e tij;

(v) paraqitjen e kërkesës për dërgim në gjyq konform nenit 327, pika 6, germa “b” dhe nenit 331 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.”

Në dispozitivin e vendimit, gjykata ka urdhëruar kthimin e akteve prokurorisë për vazhdimin e hetimeve, të cilat duhet të përfundonin brenda 2 muajve nga marrja formë e prerë e këtij vendimi.

89. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionet, si vijojnë.

“Trupi gjykues, në analizë të vendimit të organit gjyqësor, në analizë të kërkimit të organit të prokurorisë, çmon se pretendimet e subjektit lidhur me arsyen e kërkimit të pushimit të procedimit penal se falsiteti i dokumentit duhet trajtuar nëpërmjet shqyrtimit të një procesi civil për pavlefshmëri kontratash, nuk qëndron. Për sa kohë falsiteti i një dokumenti është provuar, me të drejtë gjykata ka vlerësuar se shkaktimi i pasojës nga përdorimi i saj duhet të hetohet dhe për këtë ka lënë detyrat përkatëse. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se për sa kohë kërkimi i pushimit të çështjes është prishur nga gjykata dhe, me gjithë ankimin e ushtruar që presupozohet se është

⁵⁵ *Organi i Prokurorisë është përfaqësuar në gjykim nga prokurori N.GJ.*

parashtruar në të njëjtën linjë, sikurse në këto parashtrime, dhe përsëri vendimmarrja e një shkalle më të lartë të gjyqësorit, si ajo e apelit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me gjykatën e shkallës më të ulët, veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë ndërmarrë, sikurse kërkohet në pikën 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, nuk vlerësohen pozitivisht në aspektin e njohurive ligjore duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. Po ashtu, mbi hetimin e kryer për këtë çështje, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, nëse do të kishte thëlluar hetimet e kryera, do të kishte përmbushur një ndër elementet që përfshihet në aftësitë profesionale juridike dhe teknike, konkretisht aftësinë për të kryer ndjekje penale në hetim dhe në gjyq dhe për të krijuar dhe administruar procedimin penal”.

90. Në analizë të pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit si më sipër cituar, trupi gjykues vëren se referuar disponimit të vendimit nr. {***}, datë 02.11.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk rezulton që veprimet hetimore të kryera prej subjektit të rivlerësimit të jenë të mangëta, madje gjykata ka arritur në përfundimin që duhet të njoftohet akuza, mbi të njëjtat akte dhe prova të administruara nga prokuroria. Detyrat që i janë lënë prokurorit [subjektit të rivlerësimit], nuk lidhen me veprime hetimore që duhet të ndërmerren, por me hartimin e akteve përkatëse procedurale. Vendimi i subjektit të rivlerësimit për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2018, është cenuar prej vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë [lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë], në drejtim të korrektësisë së zgjidhjes së çështjes. Në themel të vendimit të gjykatës ka qenë vlerësimi lidhur me zgjidhjen e çështjes, me mënyrën e vlerësimit të provave e interpretimit të ligjit nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e prokurorit të çështjes. Ky arsyetim i gjykatës dhe disponimi i saj në vendim kanë qëndruar në thelb të konkluzionit të Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka ndërmarrë veprimet, sikurse kërkohet nga parashikimi i pikës 2 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016⁵⁶.
91. Bazuar në sa më sipër, si dhe në faktin se gjykata nuk ka disponuar në vendim për kryerjen e veprimeve hetimore, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit lidhet me atë aspekt të aftësive profesionale të magjistratëve që nuk mund të gjykohet e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi, sipas nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, e cila detyron vlerësuesin të çmojë aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet.
92. Në lidhje me denoncimin e shtetasit I. S., subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se *vlerësimi i Komisionit nuk qëndron, pasi sipas legjislacionit procedural penal, kontrolli i gjykatës mbi vendimet e prokurorit nuk sjell në asnjë rast konkluzionin se hetimet kanë qenë të mangëta, në kuptim të përgjegjësisë lidhur me aftësitë profesionale të prokurorit.* Komisioni, në vendim⁵⁷, lidhur me këtë çështje, ka konkluduar: *Subjekti, me veprimet apo mosveprimet e tij, në vendimin e pushimit të procedimit penal, në datën 22.03.2012, ka vepruar në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, si dhe me rregulloren për “Sistemin*

⁵⁶ Sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 28.10.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i paraqitur si provë nga subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrimet para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, kjo gjykatë, më datë 04.11.2020, i dha fund shqyrtimit gjyqësor me dyer të hapura të çështjes penale nr. {***} regj. themeltar, duke vendosur “Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit F.Ll. për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal”.

⁵⁷ Faqja 53 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

*e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. {***}, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, nëse do të kishte thelluar hetimet e kryera, do të kishte përmbushur një ndër elementet që përfshihet në aftësitë profesionale juridike dhe teknike, konkretisht aftësinë për të kryer ndjekje penale në hetim dhe në gjyq dhe për të krijuar dhe administruar procedimin penal në kohë, si dhe për të realizuar një procedim penal efektiv me qëllim edhe garantimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve.*

93. Në analizë të këtij shkakut ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se:

93.1 Më datë 22.03.2012, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit I. S. kundër shtetasës E. P., me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Legalizimit pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t Tiranë, bazuar në shkronjën “dh” të nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale.

93.2 Mbi bazën e ankimit të kallëzuesit I. S., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 25.09.2013, ka vendosur rrëzimin e kërkesës penale nr. {***} regj. themeltar, datë 18.04.2012. Ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë duke kundërshtuar këtë vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 28.03.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, datë 05.10.2011, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e akteve atij organi për vazhdimin e hetimit të çështjes.

Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar: “[...] Gjykata e Apelit Tiranë çmon se organi i prokurorisë duhet të hetonte më me imtësi faktin e kallëzuar, sidomos lidhur me përcaktimin e momentit se kur është ndërtuar objekti i kallëzuar, në raport me momentin kur shtetasi i kallëzuar ka fituar pronësinë dhe atë kur ka aplikuar për legalizim. Organi i prokurorisë duhet gjithashtu të hetojë lidhur me ndërtimin nëse është shtesë apo ndërtim i ri. Organi i prokurorisë duhet të administrojë praktikën e legalizimit në raport me të dhënat eventuale që do të rezultojnë nga veprimet e sipërcituara hetimore”.

93.3 Mbi bazën e fakteve të konstatuara si më sipër, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për gjetjen: *Dukej se hetimi i kryer nga organi procedues deri në vendimin e pushimit të datës 22.03.2012, nuk ka qenë i plotë, konstatim ky i dalë edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {***}, datë 28.03.2014, e cila e ktheu për rihetim procedimin penal nr. {***} të vitit 2011.*

93.4 Në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime⁵⁸ në lidhje me ecurinë e çështjes pas kthimit të saj për rihetim sipas vendimit të Gjykatës

⁵⁸ Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar: “Pas urdhërimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, si prokuror i çështjes, ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata dhe në datën 09.04.2015, është vendosur pushimi i procedimit penal nr. {***}/2011. Kundër këtij vendimi, ankuesi I. S. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 10.03.2016 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi ankuesi I. S. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 16.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjykues me urdhërimin për thirrjen nga gjykata të personave të kallëzuar për të marrë pjesë në gjykim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas rigjykimit të çështjes me vendimin nr. {***} akti, datë 14.06.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të ankuesit. Kundër këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit Tiranë ka paraqitur ankim shtetasi I. S. dhe kjo gjykatë, me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

së Apelit Tiranë nr. {***}, datë 28.03.2014, duke mos iu përgjigjur barrës së provës së kaluar nga Komisioni. Edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar të njëjtat pretendime që nuk lidhen me thelbin e konkluzionit të Komisionit, pa arritur të argumentojë pse ky konkluzion nuk qëndron.

94. Në lidhje me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, se kontrolli i gjykatës mbi vendimet e prokurorit nuk sjell në asnjë rast konkluzionin se hetimet kanë qenë të mangëta në kuptim të ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues vëren se ky ligj, në nenin 77 të tij, nuk ka renditur në mënyrë të shprehur në burimet e vlerësimit të magjistratëve kontrollin e gjykatës mbi vendimet e prokurorit, por në shkronjën “dh” ka renditur: “Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime: dh) të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit”. Në rastin konkret, qëllimi i Komisionit nuk ka qenë verifikimi i vendimeve të marra nga subjekti i rivlerësimit dhe për të cilat gjykatat kanë disponuar me kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve, por verifikimi i denoncimit të paraqitur nga denoncuesi I. S., i cili ka bërë pjesë të denoncimit të tij vendimin e pushimit të procedimit penal të marrë nga subjekti i rivlerësimit më datë 22.03.2012, dhe atë të datës 09.04.2015. Në kushtet kur vendimmarrja e datës 22.03.2012 e subjektit të rivlerësimit është vlerësuar e padrejtë për shkaqe të mungesës së hetimeve të thelluara, vlerësojmë se Komisioni ka vepruar drejt kur ka përfshirë faktet e këtij denoncimi në shqyrtimin e kriterit të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, referuar edhe parashikimit ligjor të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur pretendime konkrete, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit në lidhje me këtë çështje.
95. Në lidhje me shkakun e ankimit, sipas të cilit *vlerësimi i Komisionit në lidhje me informacionin publik mediatik, por edhe nga një denoncim i publikut, për procedimin penal nr. {***/2017 në ngarkim të shtetasit F. Ç., nuk qëndron*, trupi gjykues vëren se Komisioni, në vendim⁵⁹, ka arritur në konkluzionin: “Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime hetimore, por nuk ka përmbushur detyrën e tij për të zgjeruar rrethin e hetimeve lidhur me mbledhjen e provave dhe fakteve për të provuar mbi vërtetësinë e bisedave të shfaqura në DVD, apo për të pyetur në cilësinë e personave që mund të tregojnë të tjera rrethana, ndërsa kishte pyetur vajzën e pacientit e cila nuk ka qenë prezantuar në biseda, si dhe nuk ka përmbushur një detyrë të rëndësishme, atë të kërkimit të kryerjes së aktekspertizës, lidhur me vërtetësinë e fakteve dhe rrethanave të ekspozuara në DVD, për më tepër që në asnjë moment nuk është mohuar se personi i shfaqur në video nuk ishte mjeku i pretenduar si i përfshirë në kryerjen e veprës penale. Trupi gjykues çmon gjithashtu se arsytet që parashtron subjekti mbi moskryerjen e ekspertizës së zërit në kohën e zhvillimit të hetimeve paraprake, përfshirë këtu edhe koston që do të sillte kryerja e aktit, nuk qëndrojnë, për faktin se, ose kryerja e një akti të tillë është domosdoshmëri sepse realizon zhvillimin e kërkimeve ose marrjen e të dhënave ose të vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, ose, për sa kohë pamjet filmike nuk kundërshtohen, atëherë duhen zgjeruar hetimet me qëllim vërtetësinë e plotë të të dhënave të ngjarjes. Trupi gjykues nuk vlerëson bindjet e parashtruara të subjektit të rivlerësimit në raport me faktet e konstatuara të cilat duket se, për shkak të një hetimi të mangët, nuk kanë marrë zgjidhje, duke cenuar besimin e publikut edhe për vetë faktin se denoncimi ishte bërë mediatik”.
96. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të këtij konkluzioni të Komisionit, ka parashtruar në ankim argumentet si vijojnë.
- (i) Konkluzionet në vendim lidhur me analizën e kësaj çështjeje, janë thuajse tërësisht të ndryshme nga gjetjet e Komisionit të reflektuara në rezultatet e hetimit administrativ. Në vendim, Komisioni është tërhequr nga disa prej atyre veprimeve hetimore që duhet të ishin kryer nga ana e

⁵⁹ Faqe 57 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

subjektit të rivlerësimit për të provuar faktin penal, duke treguar dhe provuar kështu paligjshmërinë e Komisionit për të vlerësuar mbi themelin e çështjes, logjikën dhe interpretimin e prokurorit në këtë çështje.

(ii) Komisioni ka fshehur dhe nuk ka pasqyruar vlerësimin e organit vlerësues, KLP-së, lidhur me këtë çështje.

(iii) Hetimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me procedimin penal nr. {***}/2017, kanë qenë shteruese, referuar nenit 259 të Kodit Penal dhe ndaj vendimit të tij për pushimin e procedimit, nuk është paraqitur ankim.

97. Në analizë të këtij shkaku ankimi, nga aktet e administruara nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si vijon.

97.1 Më datë 15.03.2017, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është referuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, vepra penale “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal. Sipas rrethanave të përshkruara në referim, në datën 01.03.2017, në emisionin investigativ “{***}”, në Televizionin Kombëtar {***} janë shfaqur pamje filmike në të cilat dalin në pah veprime korruptive të kryera nga mjeku F. Ç., shef i Kirurgjisë Torakale në Spitalin Universitar “{***}” Tiranë. Në pamjet filmike të transmetuara, dyshohet se shfaqet mjeku i cili merr një shumë parash nga familjari i një pacienti që i ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale.

97.2 Nga oficeri i Policisë Gjyqësore pranë Policisë së Shtetit janë kryer këto veprime: Më datë 02.03.2017, ka mbajtur procesverbal mbi “Këqyrjen, marrjen e provës materiale”, sipas të cilit janë marrë dokumente për interes të hetimit që i përkasin mjekut F. Ç. Në të njëjtën datë është mbajtur procesverbal për transkriptimin e bisedave të transmetuara në emisionin investigativ dhe për kërkimin e shtetasit/mjekut F. Ç.

97.3 Më datë 10.03.2017, është mbajtur procesverbal për deklarime nga persona që tregojnë rrethana të hetimit, më konkretisht, nga shtetasja F. K., vajza e pacientit, e cila është shprehur se nuk ka dijeni për rastin.

97.4 Drejtori i programit televiziv “{***}” i është drejtuar me shkresën e datës 13.03.2017, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, nëpërmjet së cilës bën me dije se vendos në dispozicion pamjet bruto të ngjarjes, të transmetuara në datën 01.03.2017. Në lidhje me të dhënat e personit që ka bërë filmimin, drejtori i programit “{***}”, shprehet se e kanë të pamundur të japin të dhëna, pasi bëhet fjalë për gazetarë investigativë të programit, identitetin e të cilëve nuk mund ta publikojnë për shkak të profilit të punës dhe dekonspirimit të gazetarëve.

97.5 Më datë 28.03.2017, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit, ka regjistruar procedimin penal të sipërcituar, lidhur me veprën penale “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

97.6 Më datë 01.04.2017, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar: kryerjen e transkriptimit të plotë të bisedave sipas përmbajtjes së CD-së së dërguar nga emisioni “{***}”; të hetohet dhe të identifikohet personi që ka kryer ndërhyrjen te spitali “{***}” dhe të pyetet; në rast se konstatohen elemente të vetinkriminimit, të zbatohet dispozita e nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale; të administrohet kartela klinike e personit që ka bërë ndërhyrjen; të pyeten anëtarë të tij të familjes lidhur me sa ka rezultuar nga pamjet televizive dhe transkriptimet e bisedave, brenda 40 ditëve.

97.7 Më datë 15.05.2017, prokuroria i ka dërguar materialin në formatin DVD për transkriptim Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me qëllim transkriptimin e pamjeve filmike bruto të

transmetuara në programin investigativ “{***}” në TV “{***}” dhe në datën 31.05.2017, është mbajtur procesverbali për transkriptimin e bisedave të regjistruara në formatin DVD.

97.8 Më datë 05.06.2017, është mbajtur procesverbal mbi deklaratimet e shtetasit F. Ç., i cili nuk ka pranuar të ketë marrë para për ndërhyrjen kirurgjikale dhe se video e shfaqur është një montim, pasi ai nuk kujtonte të ishte gjendur në një situatë të tillë me pacientin apo familjarë të tij.

97.9 Më datë 08.06.2017, oficeri i policisë gjyqësore ka sugjeruar pushimin e procedimit penal, ndër të tjera edhe për faktin se nga hetimet e kryera ka rezultuar që nga familjarët e pacientit, nuk është shkuar për t’u ankuar në programin “{***}”, zëri i shfaqur në filmime nuk është i tyre dhe se prej tyre nuk është dhënë ndonjë shumë parash.

97.10 Më datë 13.06.2017, subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal nr. {***}/2017, bazuar në nenin 328, shkronja “dh” e Kodit të Procedurës Penale.

98. Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike të pasqyruar më sipër, trupi gjykues vlerëson si vijon.

Lidhur me pretendimin se pjesa e vendimit lidhur me analizën e kësaj çështjeje është thuarje tërësisht e ndryshme nga gjetjet e Komisionit të reflektuara në rezultatet e hetimit administrativ, konstatohet se në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës, ndër të tjera, edhe në lidhje me “[...] duket se në mbështetje të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm mund të ishin marrë në cilësinë e personave që kanë dijeni për investigimin edhe drejtuesit e programit, sigurisht duke ruajtur anonimitetin/ konfidencialitetin”. Në lidhje me këtë gjetje, Komisioni në vendim ka arsyetuar se: “Për sa i përket pyetjes në kushtet e ruajtjes së anonimitetit të drejtuesve të programit “{***}”, subjekti ka sqaruar se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon pyetje të personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit në kushte anonimatit, apo konfidencialiteti për këtë veprë penale”. Në këto kushte, në ndryshim nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, rezulton se Komisioni ka marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna prej tij, në lidhje me gjetjen e sipërcituar.

99. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka fshehur dhe nuk ka pasqyruar vlerësimin e organit vlerësues, KLP-së, lidhur me këtë çështje, nga verifikimi i akteve të hetimit administrativ, konstatohet se Komisioni, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.05.2019, me lëndë “Kërkesë për informacion dhe vlerësim të çështjeve konkrete”, drejtuar KLP-së, i ka kërkuar këtij të fundit një vlerësim profesional të vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera edhe për denoncimin e shtetasit F. D. KLP-ja i ka përcjellë Komisionit vlerësimin mbi sa i është kërkuar nëpërmjet shkresave nr. {***} prot., datë 21.06.2019 dhe nr. {***} prot., datë 30.07.2019. Në të kundërt nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Komisioni nuk ka fshehur faktin e vlerësimit të dhënë nga KLP-ja në lidhje me denoncimet e depozituara për subjektin e rivlerësimit, pasi konstatohet se në vendim⁶⁰, është shprehur: *Për një hetim objektiv, pasojat e të cilit ndikojnë në përmbushjen me korrektësi dhe profesionalizëm të funksionit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi një raport të specializuar edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke i vënë në dispozicion denoncimet përkatëse, pas të cilit ky i fundit dërgoi raportin e parë, si dhe një raport shtesë mbi to. Në vijim, trupi gjykues, pas analizimit të dy raporteve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të të gjithë dokumentacionit mbështetës të depozituar, jo vetëm nga ky i fundit, por edhe nga denoncuesit, ka konstatuar se nga 31 denoncimet, 16 prej tyre nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.*

⁶⁰ Faqe 39 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

Gjithashtu, nga përmbajtja e vendimit, rezulton se në analizën e bërë në lidhje me informacionin e bërë publik në media, Komisioni ka pranuar vlerësimin e KLP-së se: *Referenca ligjore e pushimit të kësaj çështjeje është shkronja "dh" e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, e cila ka të bëjë me mungesën e provueshmërisë së kryerjes së kësaj veprë penale dhe kjo referencë ligjore është e duhura në rastin konkret.* Pavarësisht kësaj, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se Komisioni duhet të kishte konsideruar vlerësimin e bërë nga KLP-ja, është i pabazuar në ligj, pasi sipas neneve 45 e 50 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit kanë detyrimin të kryejnë hetim të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes. Kjo dispozitë është në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit Komisioni ka tagrin që, pavarësisht rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, përfshirë edhe KLP-në, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit.

100. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se hetimet e kryera lidhur me procedimin penal nr. {***}/2017 kanë qenë shteruese, referuar nenit 259 të Kodit Penal dhe ndaj vendimit të tij për pushimin e procedimit, nuk është paraqitur ankim, trupi gjykues konstaton se konkluzionet e Komisionit lidhen me faktin se subjekti i rivlerësimit nuk ka urdhëruar kryerjen e aktit të ekspertimit të zërit për të qartësuar nëse zëri i doktorit i përket shtetasit F. Ç. Në lidhje me sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në shpjegimet mbi rezultatet e hetimit administrativ dhe në ankim, ka sqaruar se *kryerja e një ekspertize të zërit nuk ishte konsideruar e nevojshme në kohën e zhvillimit të hetimeve paraprake, për sa kohë që subjekti, si prokuror i çështjes, nuk kishte pasur dyshime se personi i identifikuar në pamjet filmike të mos ishte shtetasi F. Ç. dhe nga ky i fundit nuk ishte pretenduar një gjë e tillë. Në këto rrethana, kryerja e një akti të tillë ekspertimi do të sillte kosto për dosjen dhe jo një zhvillim me interes.* Por shpjegimi mbi të cilin subjekti i rivlerësimit ka mbështetur mbrojtjen e vet, është si vijon: *Si prokuror, kam vlerësuar nisur edhe nga praktika e deritanishme se filmime të tilla janë konsideruar dhe do të konsiderohen si prova atipike, të cilat edhe pse në kushtet e administrimit jashtë kritereve procedurale penale, marrin fuqi provuese kur identifikohet burimi i krijimit të provës dhe kur lidhen me të dhëna të tjera të mbledhura nga hetimet paraprake. Vepra penale e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, sipas nenit 259 të Kodit Penal, parashikon kërkimin ose marrjen drejtpërdrejt ose tërthorazi të çdo lloj përfitimi të parregullt ose të një premtimi të tillë për vete ose për persona të tjerë, apo pranimin e një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt nga personi që ushtron funksione publike për të kryer ose mos kryer një veprim. Sipas këtij parashikimi, çmoj se pavarësisht se kur merret përfitimi i parregullt, premtimi i paraprin në çdo rast veprimit ose mosveprimit të funksionarit që ka lidhje me detyrën. Nga hetimet rreth atij procedimi penal, nuk u provua që shtetasi F. Ç., në këmbim të kryerjes së detyrës së tij, të kishte kërkuar apo t'i ish in premtuar shuma parash. Vetë familjarët e pacientit kishin deklaruar se nuk kishte pasur asnjë bisedë për pagesë për shtetasin F. Ç.*

Bazuar në këto shpjegime të subjektit të rivlerësimit, si dhe në situatën faktike të pasqyruar më sipër në këtë vendim, mbi veprimet hetimore të urdhëruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se ai ka kryer veprimet hetimore të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, për pasojë vlerësimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetime të plota që do të ndikonin në zgjidhjen e çështjes, nuk qëndron.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit është i bazuar.

101. Në lidhje me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit *konkluzioni i Komisionit në vendim se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke aplikuar si bazë shkarkimi pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 nuk mund të qëndrojë as logjikisht dhe as ligjërishit*, trupi gjykues vëren se Komisioni në vendim, ka arritur në konkluzionin: *Trupi gjykues, lidhur me vlerësimin profesional, gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara për moskryerje të hetimeve të plota, mosadministrimin e procedimeve penale, mosrealizimin e procedimeve penale në mënyrë efektive dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për sa kohë që jo në pak çështje të adresuara nga një numër i lartë i denoncuesve, u konkludua se vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit ishin prishur nga organet e gjyqësorit, madje edhe në mënyrë të përsëritur, i vlerëson ato si veprime dhe mosveprime të kryera, jo për shkak të paaftësisë profesionale të subjektit, por që dëshmojnë për sjellje të tij në mospërbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016⁶¹.*
102. Në kundërshtim të konkluzionit të mësipërm të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në ankim, se pika 5 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, imponon një arsyetim të zgjeruar dhe më se të justifikuar, në mënyrë që të plotësohen vërtet kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, pasi aplikimi i saj pa kriter, në rastin e shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, e kthen vendimin e Komisionit në një vendim abuziv dhe dukshëm të njëanshëm.
103. Në analizë të këtij shkakut ankimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se Komisioni në konkluzionet e shprehura në vendim, për secilën nga çështjet e analizuar në kuadër të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, ka arritur në përfundimin se veprimet ose mosveprimet e subjektit të rivlerësimit nuk kanë përmbushur një prej aftësive të parashikuara në nenet 73 ose 74 të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, lidhur me kriteret e vlerësimit të prokurorit. Në këto kushte, në vështrim të përgjithshëm, pa u ndalur në bazueshmërinë e konkluzioneve të Komisionit për secilën nga çështjet, trupi gjykues çmon se Komisioni nuk ka arritur të argumentojë se përse veprimet e konsideruara si paaftësi profesionale e subjektit të rivlerësimit gjatë trajtimit të secilës prej çështjeve, në përfundim, nuk janë konsideruar më si të tilla, por si veprime dhe mosveprime që dëshmojnë për sjellje të tij në mospërbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Vetëm në vlerësimin e procedimit penal nr. {***/2017, në ngarkim të shtetasit F. Ç., i hetuar dhe vlerësuar nga Komisioni nga denoncimi i z. F. D., si dhe për shkak se rasti ishte bërë publik nga emisioni investigativ “{***}” në Televizionin Kombëtar {***}, Komisioni ka konkluduar se *nuk vlerëson bindjet e parashtruara të subjektit të rivlerësimit në raport me faktet e konstatuara, të cilat duket se për shkak të një hetimi të mangët nuk kanë marrë zgjidhje, duke cenuar besimin e publikut edhe për vetë faktin se denoncimi ishte bërë mediatik.*
104. Pavarësisht analizës si më sipër, trupi gjykues vlerëson se aplikimi i pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 duhet të ndodhë për shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016. Cenimi i besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të kësaj dispozite, duhet të mbështetet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit apo në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi, e jo duke analizuar

⁶¹ Faqe 59 e vendimit nr. 199, datë 11.10.2019, të Komisionit.

në mënyrë të veçantë vetëm njërin prej kriterëve të rivlerësimit, në rastin konkret vetëm kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

105. Mbështetur në sa më sipër, por edhe në konkluzionet e arritura për secilën prej çështjeve të marra në shqyrtim në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, në përfundim të shqyrtimit të të cilave pretendimet e subjektit të rivlerësimit u gjetën të bazuara, trupi gjykues vlerëson se në vlerësimin tërësor të çështjes, subjekti i rivlerësimit nuk ka cenuar besimin e publikut të drejtësia sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
106. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, pasi analizoi të gjitha shkaqet e ankimit dhe kërkimet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të gjitha provat e aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ për këtë çështje, arriti në përfundimin se vendimi nr. 199, datë 11.10.2019, i Komisionit nuk është i drejtë, bazuar në konkluzionet si vijojnë.

I. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

a) Subjekti i rivlerësimit, edhe pse ndodhet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme financiare në vlerën 536.818 lekë, për pagesën e këstit të dytë të pasurisë apartament banimi në Tiranë, për blerjen e pasurisë automjet tip “Citroen C 5”, si dhe për përballimin e shpenzimeve të kryera gjatë vitit 2016, në përputhje me parashikimin e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ajo nuk konsiderohet se shërben për t’u kualifikuar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

b) Subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme financiare të mjaftueshme për të blerë pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz” në vitin 2009 [dhe shitur në vitin 2016], si dhe për të mbuluar shpenzimet e këtij viti dhe, për rrjedhojë, nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

c) Referuar tërësisë së akteve të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk u arrit të provohet se subjekti i rivlerësimit ka kontribuar në krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 65 m²” në Tiranë dhe se ai posedon/zotëron 1/3 pjesë takuese të kësaj pasurie, për pasojë ai nuk ka detyrimin të justifikojë burimin e ligjshëm të këtij kontributi.

ç) Komisioni, duke i konsideruar prindërit e subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur dhe duke e ngarkuar subjektin me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të kursimeve të tyre, nuk ka kualifikuar në mënyrën e duhur dhe të plotë situatën faktike e, për pasojë, ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin. Prindërit e subjektit të rivlerësimit nuk mund të konsiderohen si persona të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi, bazuar në parashikimin e pikës 14 të nenit 3, si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nuk u provua që ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe prindërve tij të ketë pasur marrëdhënie interesi në lidhje me krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 65 m², në Tiranë, apo dhe të ndonjë pasurie tjetër, për sa kohë nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit kundrejt prindërve të tij, lidhur me këto pasuri. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit nuk ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në posedim/zotërim të prindërve të tij.

107. Trupi gjykues, bazuar në sa më sipër, vlerëson se subjekti i rivlerësimit kalon testin e standardit kushtetues dhe ligjor të shpjegimit dhe provimit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së tij, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, për rrjedhojë ai gjendet në kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, duke arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë.

II. Në lidhje me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se:

108. Kolegji, pasi analizoi të gjitha gjetjet e paraqitura në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit në lidhje me kontrollin e këtij kriteri nuk është rezultat i një vlerësimi të drejtë dhe në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi. Kolegji konstaton se konkluzionet e Komisionit në lidhje me disa prej dosjeve penale të analizuara, përbëjnë vlerësime e qëndrime në kapërcim të objektit të organeve të rivlerësimit lidhur me kontrollin e këtij kriteri, sipas parashikimit të nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Kolegji konstatoi gjithashtu se gjetjet e Komisionit të cilat u konsideruan si të bazuara, ishin të tilla që nuk mjaftonin për të kualifikuar aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit nën nivelin minimal kualifikues. Për rrjedhojë, trupi gjykues konkludoi se subjekti i rivlerësimit është në kushtet e nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

109. Në vlerësimin tërësor të çështjes dhe kuadrit ligjor në fuqi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se zbatimi nga Komisioni i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton shkarkimin nga detyra për subjektin e rivlerësimit, është i gabuar.

110. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur, në mënyrë kumulative, nivel të besueshëm në të tria kriteret e rivlerësimit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut, për pasojë ndodhet në kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

111. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, në zbatim të neneve D dhe E të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 4, pikat 2 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi nr. 199, datë 11.10.2019, i Komisionit duhet ndryshuar, pasi ai nuk gjendet i drejtë dhe i bazuar në fakte e ligj.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 199, datë 11.10.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Ndini Tavani dhe konfirmimin e tij në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 03.11.2021.

ANËTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi